



RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

(Auditim Financiar)

**“INSPEKTORATI QËNDROR”
TIRANË**

NËNTOR, 2019



**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
(Auditim Financiar)**

“Inspektorati Qëndror”

<i>Nr</i>	<i>Përmbatja</i>	<i>Faqe</i>
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	3
II.	HYRJA (Të dhëna mbi Projektin e Auditimit)	
a.	Objektivat dhe qëllimi.	5
b.	Identifikimi i çështjes.....	5-6
c.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	6
d.	Përgjegjësitë e audituesve.....	6
e.	Kriteret e vlerësimit.....	6-7
f.	Standardet e auditimit.....	7
	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....	7
	III. DREJTIMET E AUDITIMIT	
1.	Auditimi i pasqyrave financiare.....	9-24
2.	Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar	24-27
3.	Të tjera që rezultojnë gjatë auditimit	27-20
	GJETJE DHE REKOMANDIME	29-31
IV.	ANEKSE	32-39



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “INSPEKTORATIN QËNDROR”

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I/a. Përshkrim i shkurtër i Auditimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi “Inspektorati Qendror” (IQ), duke i kushtuar vëmendjen e posaçme, ndër të tjera, çështjeve që lidhen me:

1. Auditimi i pasqyrave financiare
2. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar
3. Të tjera që rezultojnë gjatë auditimit

I/b. Përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi

R	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1	Inspektorati Qendror nuk ka përgatitur raportet e monitorimit 4, 8, 12 mujore me relacione shpjeguese të realizimit të tregusve me planin, si dhe masat korrigjuese që duhet të ndërmerren për përmirësimin e situatës. Veprime në mospërputhje me pikën 3.3/33 kapitulli III, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore.		MESEM	Inspektorati Qendror të marrë masa në vazhdimësi, që të përpilojë raportet e monitorimit 4,8,12 mujore ku të relatohet në lidhje me realizimin e treguesve në raport me parashikimin, me qëllim menaxhimin sa më efektiv të fondeve buxhetore, si dhe ndërmarrjen në kohë të veprimeve korrigjuese duke ndryshuar alokimin e burimeve, si dhe duke evidentuar impaktin e mundshëm në performancën e objektivave të lidhura me to. Në raportet e monitorimit për 8- mujor të jepet informacionet shtesë për parashikimin e realizimeve të pritsëm deri në fund të vitit si për produktet edhe për shpenzimet, për të evidentuar nëse ky parashikim është më i lartë apo më i ulët se plani fillestar i parashikuar, Gjthashtu IQ të marrë masat në vazhdimësi, që Raporti e Monitorimit të publikohen në faqen zyrtare e tyre zyrtare në web.
2	Nga kontrolli i zërave të pasqyrës së ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto dhe të pasqyrës së pozicionit financiar rubrika C u konstatua se, llogaria 105 “Teprica e Granteve kapitale të Brendshme” dhe llogaria 106 “Teprica e Granteve kapitale të Huaja” rezultojnë me tepricë në fund të periudhave ushtrimore, çka do të thotë se këto grante janë burim për investimet në proces për institucionin (të papërfunduara ose të pamarrë në dorëzim). Por nga analiza e zërave të pasqyrës nuk rezultojnë që institucioni të ketë investimet në proces (të papërfunduara ose të pamarrë në dorëzim). IQ-rë i ka marrë në dorëzim të gjitha investimet e realizuara në vite dhe i ka kapitalizuar në llogarinë 21. Pra rezultojnë se institucioni në fund të periudhës kontabël nuk ka bërë veprimin e mbylljes duke debituar 105 “Teprica e granteve kapitale të brendshme” ose 106 “Teprica e granteve kapitale të huaja”; dhe kredituar llogarinë 1011 “Shtesa në fondet bazë”. Veprime në mospërputhje me pikën 1.1 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i klasës 1” të udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësinë e qeverisjes së përgjithshme”.		MESEM	Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse së IQ të marrë masat për sistemimin e llogarisë 105 “Teprica e Granteve kapitale të Brendshme” për shumën (147,553,600) lekë dhe llogarisë 106 “Teprica e Granteve kapitale të Huaja” për shumën 558,200 lekë duke debituar tepricën e tyre dhe kredituar llogarinë 101 “Fonde Bazë”, veprime të cilat do të reflektohen në pasqyrat financiare të vitit 2019.
3	Llogaria 230 “Per aktive afatgjata jomateriale” në vlerën 27,220,800 lekë dhe llogaria 231 “Per aktive afatgjata materiale” në vlerën 48,996,750 lekë kanë të bëjnë më aktive afatgjata, para se të vihen në shfrytëzim, pra para se këto aktive të jenë funksionale ato detyrimisht duhet të gjenden në proces, në formën e shpenzimeve që grupohen në llogarinë 23 “Investime”. Nga analiza e zërave të investimit dhe kapitalizimit të tyre u konstatua se këto investime nuk janë në proces janë investime të përfituara dhe të marra në dorëzim nga institucioni, të cilat kanë të bëjnë më shërbimin e mirëmbajtjes së		MESEM	Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse së IQ të marrë masat për sistemimin e llogarisë 230 “Per aktive afatgjata jomateriale” në vlerën 27,220,800 lekë dhe llogaria 231 “Per aktive afatgjata materiale” në vlerën 48,996,750 lekë duke i kapitalizuar në llogarinë 20-21 dhe në fund të vitit 2019 këto shuma të kalojnë për llogari të AKSHI-it . veprime të cilat do të reflektohen në pasqyrat financiare të vitit 2019.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “INSPEKTORATIN QËNDROR”

	<p>sistemit të Inspektoratit, në bazë të kontratës 4-vjecare me nr. 130/1, datë 01.01.2014 deri me datën 31.12.2017 dhe amendimit nr. 702, datë 28.12.2017 për shtesë kontrate.</p> <p>Institucioni në fund të periudhës ushtrimore të vitit 2018 duhet ti kapitalizonte në grupet 20 e 21 të aktiveve të përfunduara dhe vlera totale prej 76,217,550 lekë duhet të kalonte e kapitalizuar bashkë me sistemin të AKSHI në mbështetje të pikave 18-20 të VKM-së nr .673, datë 22.11.2017 “Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, e dorëzuar me Akt-dorëzimin nr.440\2, datë 09.10.2018.</p>			
4	<p>Në fund të procesit të inventarizimit u konstatua se komisioni nuk ka përpiluar një raport në lidhje me inventarizimin fizik të aktiveve, ku të japtë komentet në lidhje me gjendjen fizike aktuale të aktiveve (nëse janë apo jo në përdorim), si dhe për kushtet e ruajtjes së tyre dhe së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzonte për veprime të mëtejshme titullarit të institucionit, veprime në kundërshtim me pikën 85/c të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.</p> <p>- Nga auditimi u konstatua se para fillimit të inventarit nuk ishte vendosur numri rendor i fletë hyrjes dhe i fletë daljes nëpërmjet një procesverbal, i cili mbahet midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit, veprim në kundërshtim me pikën 83 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011.</p> <p>- Për vitet objekt auditimi u konstatua se komisioni i inventarizimit nuk ka nxjerrë një vlerë totale dhe listë të detajuar, se sa ka gjendje fizike institucioni, për pajisje informatike, për pajisje zyre të ndarë në artikuj, si dhe mjete transporti në dispozicion etj., sipas formatit të regjistrimit të aktiveve, i cili hartohet në vartësi të llojit të tyre, si dhe grupit përkatës brenda llojit dhe më pas të bëhej krahasimin gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të regjistruara në kontabilitet, për të vërtetuar nëse ekzistojnë apo jo diferenca, veprime në kundërshtim me pikat 30, 73, 74, 81 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011.</p>		MESEM	<p>Komisioni i inventarizimit, i cili ngrihet çdo vit nga Titullari i Institucionit të IQ-rë të marrë masa, që në raportin që i drejtohet titullarit në fund të procesit të inventarizimit, të bëjë një ndarje të aktiveve gjendje që disponon institucioni, sipas zërave duke bashkëngjitur listën e tyre në relacionin, me qëllim verifikimin reale të gjendjes së tyre, si dhe verifikimin më lehtësisht të diferencave të gjendjes së tyre fizike me të dhënat e regjistruara në kontabilitet sipas zërave. Në momentin që komisioni i ngritur nuk arrin të bëjë inventarizimin e zërave të caktuar të kërkojë nga titullari, për të ngritur grup pune me ekspertë të fushës, për aktivet që nuk mund ti inventarizojnë.</p>
5	<p>Nga auditimi i procedurave të prokurimit nuk janë hartuar procesverbale për shpalljen e fituesit në rastet kur ofertuesi i renditur në vend të parë tërhiqet nga oferta e tij ose nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor sipas VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 40, pika 5,dhe Udhëzimit nr.03, Datë 8.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me Vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 17.</p> <p>- Dosjet e procedurave të prokurimeve nuk janë të inventarizuara dhe të arkivuara, në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat.</p> <p>- Nga auditimi i procedurave të prokurimit u konstatua se mungon ngritja dhe komisionit për marrjen në dorëzim dhe vlerësimin e mallrave dhe relacioni për të verifikuar nëse specifikat e mallit/shërbimit të marrë në dorëzim jenë apo janë përputhje me kriteret e parashikuara, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në njësitë e Sektorit Publik” pika 42-50.</p>		MESEM	<p>Njësia e Prokurimit të marrë masa për çdo procedurë të hartojë procesverbale për shpalljen e fituesit në rastet kur ofertuesi i renditur në vend të parë tërhiqet nga oferta e tij ose nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor.</p> <p>-Të kryhet inventarizimi dhe arkivimi i dosjeve nga Njësia e Prokurimit për çdo procedurë prokurimi.</p> <p>-Të merren masa, që për çdo marrje në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, të ngrihet komisioni i marrjes në dorëzim, i cili duhet të përpilojë procesverbalin nëse mallrat/shërbimet janë në përputhje me të dhënat e verifikuara, me faturën dhe kushtet e kontratës, pastaj të bëhet fletë-hyrja në magazinë dhe regjistrimi i tyre në kontabilitet.</p>



II. Hyrja.

Mbështetur në Ligjin 154/2014 datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr.627/1, datë 04.09.2019, në Inspektoratin Qëndror, Tiranë, nga data 05.09.2019-15.10.2019, për periudhën nga 01.01.2018 deri në 31.08.2019, u krye auditimi i Financiar në IQ.

a) Titulli:

Raporti Përfundimtar i Auditimit Financiar në Inspektoratin Qëndror (IQ).

b) Marrësi:

Ky Raport Përfundimtar i adresohet Inspektor i Përgjithshëm të IQ-rë, Z. Shkëlqim Hajdari

METODOLOGJIA DHE OBJEKTIVAT E AUDITIMIT

a) Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e pasqyrave financiare janë:

-Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim si; përkatësia, plotësia, saktësia, periudha, klasifikimi, ligjshmëria dhe rregullsia.

-Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës si; ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi.

-Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese si; transaksione, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, klasifikimi dhe kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinioni nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare.

Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet e përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar.

b) Identifikimi i çështjes:

Inspektorati Qendror ka për mision përmirësimin e efektivitetit dhe përgjegjshmërisë së veprimtarive të inspektimit në Republikën e Shqipërisë.

Inspektorati Qëndror ka këto funksione: Bashkërendon dhe mbështet veprimtarinë e inspektorateve shtetërore e të inspektorateve vendore; Jep mendim këshillimor për programet e inspektimit, të hartuara nga inspektoratet shtetërore; Miraton rregulla të përgjithshme, bazë, për metodologjinë e vlerësimit të riskut, programimin e inspektimeve, dokumentimin e veprimtarisë së inspektimit, si dhe raportimin e veprimtarisë së inspektorateve; Miraton rregulla të përgjithshme për treguesit e përgjithshëm të efektivitetit dhe të cilësisë së veprimtarisë së inspektimit, si dhe kriteret e vlerësimit të tyre; Jep mendime për çdo nismë ligjore dhe nënligjore në fushën e inspektimit; Mbikëqyr zbatimin e këtij ligji e të ligjit të posaçëm nga inspektorët shtetërorë, për programimin, autorizimin dhe kryerjen e procedimit të inspektimit, dhe ka të drejtë të propozojë marrjen e masave disiplinore ndaj inspektorëve dhe Kryeinspektorit Shtetëror, në rast të konstatimit të shkeljeve prej këtyre të fundit; Përgatit raportin vjetor të përgjithshëm të inspektimeve dhe ia paraqet për njohje Këshillit të Ministrave; Bashkërendon veprimtarinë e trajnimit e të kualifikimit të inspektorëve; Miraton kërkesat specifike për arsimimin e inspektorëve në inspektoratet shtetërore dhe vendore; Kryen testimin fillestar dhe periodik të inspektorëve; Krijon dhe mban një portal unik të inspektimit, që shërben për programimin dhe



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “INSPEKTORATIN QËNDROR”

bashkërendimin e inspektimeve, shkëmbimin e të dhënave ndërmjet inspektorateve të ndryshme, si dhe për informimin e publikut; Mban listën e përditësuar të inspektorëve në detyrë për çdo inspektorat shtetëror dhe vendor dhe e publikon atë në faqen zyrtare të internetit.

Aktivitetet që do të jenë objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në programin e auditimit nr.627/1, datë 04.09.2019.

c) Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:

Drejtimi i Inspektoratit Qëndror është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi menaxherial është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

d) Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:

Raporti i auditimit duhet të deklarojë që përgjegjësia e audituesit është të shprehë një opinion mbi pasqyrat financiare bazuar mbi auditimin. Raporti i auditimit duhet të shprehë që auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Gjithashtu, raporti i audituesit duhet të shpjegojë që këto standarde kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim që të arrijë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale. Raporti i audituesit duhet të përshkruajë një auditim duke u shprehur se: Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për marrjen e evidencës së auditimit në lidhje me shumën dhe informacionet e dhëna në pasqyrat financiare; Procedurat e auditimit të zgjedhura janë në varësi të gjykimit të audituesit, përfshirë këtu vlerësimin e risqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, të cilat mund të vijnë si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Në vlerësimin e këtyre risqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm lidhur me përgatitjen e pasqyrave financiare të subjektit në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo me qëllimin për të shprehur një opinion mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit. Në rrethanat kur audituesi ka edhe përgjegjësinë për të shprehur një opinion mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm, në lidhje me 54 auditimin e pasqyrave financiare, audituesi duhet të mos shkruajë fjalinë, që marrja në konsideratë e kontrollit të brendshëm nga audituesi nuk ka si qëllim shprehjen e një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm; dhe Auditimi gjithashtu, përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga drejtimi si edhe paraqitjen e përgjithshme të pasqyrave financiare. Kur pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me një kuadër të paraqitjes së drejtë, përshkrimi i auditimit në raportin e audituesit duhet t'i referohet “përgatitjes dhe paraqitjes së drejtë të pasqyrave financiare të subjektit” ose “përgatitjes së pasqyrave financiare që japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë”, që është e përshtatshme sipas rrethanave. Raporti i audituesit duhet të shprehë se audituesi beson që evidenca e auditimit e marrë

e) Kriteret e vlerësimit:

- Ligjin nr. 10433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në republikën e shqipërisë”.
- Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”,
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë
- UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar.
- Ligjit nr. 109, datë 30.11.2017 “Për buxhetin e vitit 2018”,
- UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar si dhe në mbështetje të shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “INSPEKTORATIN QËNDROR”

- Ligjit nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”,
- Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar
- Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

f) Standardet e Auditimit

Auditimi bazohet në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.2015, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit:

- ISSAI 100 (*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*) që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 1000-2999 “*Udhëzues të Auditimit Financiar*”;
- ISSAI 1300 “*Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*”;
- INTOSAI GOV 9100 “*Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik*”; INTOSAI GOV 9110 “*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm*”;

III. PËSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm

Inspektorati Qendror është krijuar si institucion qendror buxhetor në varësi të Kryeministrit, bazuar në ligjin Nr.10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Inspektorati Qendror ka për mision përmirësimin e efektivitetit dhe përgjegjshmërisë së veprimtarive të inspektimit në Republikën e Shqipërisë.

Administrata e Inspektoratit Qendror zhvillon aktivitetin e saj në zbatim të rregullores së brendshme e cila është miratuar me urdhër nr.25, datë 10.08.2018 “Për Miratimin e Rregullores, Për Përcaktimin e Procedurës së Inspektiveve, si një proces i rregullt Administrativ.

Emërimi i personelit të institucionit, është bërë në zbatim të ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” si dhe në bazë të Urdhërit të nr.24, datë 03.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së IQ. Organika dhe struktura e institucionit aktualisht përfshin 25 punonjës, në zbatim të VKM-së nr.208, datë 24.04.2018, “Për shpërndarjen e punonjësve organik për njësitë e qeverisjes qendrore për vitin 2018”, Sektori i Teknologjisë së Informacionit, i kaloi. Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

2. Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit:

- Objekt i këtij auditimi është auditimi i pasqyrave financiare të IQ-rë për vitin 2018 dhe auditimi i operacioneve financiare deri me datën 31.08.2019.
- Qëllimi i auditimit: Garantimi i sigurisë së arsyeshme të situatës financiare të institucioit në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, manualit të auditimit financiar të KLSH si dhe standardet ndërkombëtare të auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit.
- Fushëveprimi i auditimit: Vlerësimi i aktivitetit të IQ-rë me qëllim dhënien e opinionit, shtrirë sipas drejtimeve të programit të auditimit. Janë audituar dokumentacionet dhe të dhënat në lidhje me subjektin për periudhën 01.01.2018-31.08.2018, ku janë mbuluar me auditim fondet e buxhetit të shtetit, si dhe janë audituar me përzgjedhje transaksionet e ndodhura në periudhën 01.01.2018-31.08.2019

A. OPINIONI I AUDITIMIT



Opinion mbi pasqyrat financiare.

Opinionin e dhënë mbi besueshmërinë e llogarive vjetore e mbështesim në konstatimet se; bilancet, deklaratat e të ardhurave, deklaratat e mbajtjes së të ardhurave, banka, janë përfshirë në deklaratat financiare. Janë marrë evidenca të mjaftueshme që të mund të japim një opinion. Deklaratat financiare janë paraqitur sipas ligjit të kontabilitetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

“Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, mbështetur në standartet ISSAI 1700 shprehim një **opinion të pakualifikuar**¹ për llogaritë vjetore të Inspektoratit Qendror duke arritur në përfundimin se pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë pozicionin financiar në datën 31 dhjetor 2018.

Në përfundim grupi i auditimit **konkludon se**, për periudhën objekt auditimi, Drejtimi i Inspektoratit Qendror nëpërmjet menaxhimit korrekt, ka kryer aktivitetin ekonomiko-financiar, në përmbushje të objektivave që parashikon kuadri ligjor dhe rregullativ në fuqi.

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare.

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të *Inspektoratit Qendror*, të vitit ushtrimor 2018, vlerat e paraqitura në postet e Formatit nr.1, Pasqyra e pozicionit financiar, Bilanci, krahasuar me vlerat e paraqitura në informacionet që jepen në formatet anekse si Formatit nr.2, Pasqyra e performancës financiare, ose pasqyra të ardhura e shpenzime, Formatit nr.3, Pasqyra e flukseve monetare (cash flow), Formatit nr.4, Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/Fondet neto, Formatit nr.5, Shënime shpjeguese për hartimin e raportimi pasqyrave financiare vjetore), Formatit nr.6, Pasqyra statistikore e investimeve dhe burimet e financimit, Formatit nr.7/a, Pasqyra gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike), Formatit nr.7/b, Pasqyra gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto), Formatit nr.8, Pasqyra statistikore dhe numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë pragun e materialitetit prej 2% (vlerën 995,446 lekë për shpenzimet) për tu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar.

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin “Përgjegjësitë e audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare” të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Subjekti, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme në auditimin pasqyrave financiare në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës të KLSH dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Inspektoratit Qendror.

Drejtimi i Inspektoratit Qendror, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Staf i drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve

¹ ISSAI 1700 - Audituesi do të shprehë një opinion i pakualifikuar kur ai arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.



financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare.

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

III. DREJTIMET E AUDITIMIT:

1. AUDITIMI I LLOGARIVE VJETORE

1. Mbajtja e kontabilitetit dhe mbyllja e llogarive vjetore në Inspektoratin Qendror për vitin 2018 është bërë në përputhje me ligjin nr. 9248, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Pasqyrat e llogaridhënies vjetore kanë të plotësuara pasqyra e pozicionit financiar të institucionit, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare (cash'floë), pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto, gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) dhe anekset përkatëse. Veprimet janë mbartur nga dokumentacioni bazë në ditarët përkatës, në librin e madh dhe më tej në pasqyrat financiare. Veprimet e regjistrimit të transaksioneve në kontabilitet janë regjistruar në ditarët respektiv, të bankës, magazinës, etj.

Pasqyra financiare e vitit 2018 është hartuar dhe depozituar më datë 25.03.2018 brenda afatit ligjor, i miratuar edhe nga Dega e Thesarit Tiranë. Pasqyra financiare është e firmosura nga Nëpunësi Autorizues dhe ai Zbatues.

1.2 Llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve

Buxheti Viti 2018

- Inspektorati Qendror është institucion buxhetor Shtetërorë i krijuar me ligjin nr. 10433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në republikën e shqipërisë”. Të gjitha veprimet financiare që kryejnë bëhen direkt me thesarin.

Fondet e çelura nga Ministria, Inspektorati i ka detajuar dhe përdorur për të mbuluar shpenzimet për fond page, sigurime shoqërore, për blerje mallra dhe shërbime si dhe për investime.

Detajimi i buxhetit është bërë në zbatim të ligjit nr. 109, datë 30.11.2017 “Për buxhetin e vitit 2018”, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar si dhe në mbështetje të shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 19433/981 datë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “INSPEKTORATIN QËNDROR”

18.01.2018, për shpenzimet korrente. Gjatë vitit buxheti ka pësuar ndryshime në zbatim të akteve normative, ku në vijim paraqiten gjithë ndryshimet që ka pësuar buxheti IQ gjatë vitit 2018

Artikulli	Shuma	Komente
600	29,844,000	Shkrese e MF Nr.19433/98, date 18.01.2018, Çelja e buxhetit
	-6,064,000	Akti nromativ nr. 2 datë 19.12.2018
	23,780,000	Buxheti (600) Dhjetor 2018

Artikulli	Shuma	Komente
601	5,823,230	Shkrese e MF Nr.19433/98, date 18.01.2018, Çelja e buxhetit
	-2260230	Akti nromativ nr. 2 datë 19.12.2018
	3,563,000	Buxheti (601) Dhjetor 2018

Artikulli	Shuma	Komente
602	10,588,888	Shkrese e MF Nr.19433/98, date 18.01.2018, Çelja e buxhetit
	4,000,000	Akti nromativ nr. 1 datë 26.07.2018
	14,588,888	Buxheti (602) Dhjetor 2018

Artikulli	Vlera	Komente
230-231, Investime te brendshme	54,326,000	Shkrese e MF Nr.19433/221, date 14.02.2018 Çelja e buxhetit
	-30310100	Akti nromativ nr. 2 datë 19.12.2018
	24,015,900	Buxheti (231) Dhjetor 2018

Burimi: Sektori i financës IQ

Realizimi i planit të buxhetit për vitin 2018

Në udhëzimin nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, neni 43 parashikon se, NA i njësisë së qeverisjes qendrore i paraqet NPA sa here i kërkohet informacion lidhur me buxhetin, por jo me pak se 3 herë në vit lidhur me raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, produktet dhe objektivat e realizuar për çdo program.

Mbështetur në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 103, datë 30.11.2017 “Për buxhetin e vitit 2018”, si dhe në zbatim të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 2, datë 06.02.2012 ”Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, si edhe ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, procesi i planifikimit dhe zbatimit të buxhetit të vitit 2018, dhe situata buxhetore me treguesit e realizimit të buxhetit të Inspektoriatit Qendror, për periudhën Janar - Dhjetor 2018, paraqitet si më poshtë:

Shpenzimet korrente

në mijë lekë

	<i>plan 2018</i>	<i>Plan ndryshuar akt nr. 1</i>	<i>Plan ndryshuar akt nr. 2</i>	<i>fakt 2018</i>	<i>% realizimit</i>
600	29,844,000	29,844,000	23,780,000	21,329,239	90%
601	5,823,230	5,823,230	3,563,000	3,383,493	95%
602	10,588,888	14,588,888	14,588,888	12,689,094	87%
606	30,000	30,000	30,000	30,000	100%
Totali	46,286,118	50,286,118	41,961,888	37,431,826	93%

Investimet



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “INSPEKTORATIN QËNDROR”

	<i>plan 2018</i>	<i>Plan ndryshuar akt nr. 1</i>	<i>Plan ndryshuar akt nr. 2</i>	<i>fakt 2018</i>	<i>% realizimit</i>
230	16,650,000	0	9,450,000	9,450,000	100%
231	37,676,000	0	14,565,900	14,565,484	100%
Totali	54,326,000	0	24,015,900	24,015,484	100%

Burimi: Sektori i financës IQ

Nga auditimi rezultoi se, totali i shpenzimeve të vitit 2018 janë realizuar në masën 61,447,310 lekë, nga 65,977,788 lekë që ishte parashikuar buxheti për këtë vit buxhetor, pra me një realizim prej 93% të planit vjetor ose me një mosrealizim prej afërsisht 4,530,478 lekë.

Shpenzimet korrente për mallra dhe shërbime (llogaria 602) për vitin 2018 kanë arritur në shumën rreth 12,689,094 lekë ose rreth 87 % e buxhetit të rishikuar, duke rezultuar me një mosrealizim prej afërsisht 1,899,794 lekë, pjesë e mbetur e pashpenzuar, e cila i është kthyer buxhetit të shtetit.

Buxheti Viti 2019

Detajimi i buxhetit është bërë në zbatim të Ligjit nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” si dhe në mbështetje të shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.22760/155 datë 23.01.2019, për shpenzimet korrente

Artikulli	Shuma	Komente
600	26,474,000	Shkresë e MF Nr.22760/155, datë 21.02.2019 Çelja e buxhetit

Artikulli	Shuma	Komente
601	4,554,000	Shkresë e MF Nr.22760/155, datë 21.02.2019 Çelja e buxhetit

Burimi: Sektori i financës IQ

Detajimi i shpenzimeve kapitale në mbështetje të shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.22760/327 datë 21.02.2019.

Artikulli	Vlera	Komente
230-231, Investime te brendshme	83,002,000	Shkresë e MF Nr.22760/327, datë 21.02.2019 Çelja e buxhetit

Burimi: Sektori i financës IQ

Periudha 8- mujore e 2019 (monitorimi realizohet çdo katër muaj)

Në zbatim të Ligjit nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, dhe në vijim të Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave nr. 1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, Inspektoratit Qendror i janë planifikuar fonde buxhetore për vitin 2019 në shumën 129,619 mijë lekë

Për 8- mujorin e vitit 2019, IQ ka realizuar një buxhet total prej 29,096 mijë lekë, nga të cilat 19,553 mijë lekë për shpenzime korrente dhe 9,542 mijë lekë për investime. Nga institucioni nuk ka asnjë relacion shpjegues dhe informacionet shtesë për parashikimin e realizimeve të pritshëm deri në fund të vitit si për produktet edhe për shpenzimet, për të evidentuar nëse ky parashikim është më i lartë apo më i ulët se plani fillestar i parashikuar. Veprime në mosperputhje me pikën 42 kapitulli III të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “INSPEKTORATIN QËNDROR”

- Në përfundim konstatoam se IQ nuk ka përgatitur dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, në Minsitrinë e Financave dhe Ekonomisë ose në njësinë qendrore raportet periodike të monitorimit (4, 8 dhe 12 mujore) në kundërshtim me kërkesat që dikton Udhëzimi nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” neni 43. Në institucion mungon relacioni shpjegues që tregon mospërputhjen e treguesve të realizuar me planin, si dhe masat korigjuese që duhet të ndërmerren për përmirësimin e situatës. Veprime në kunsërshtim me pikën 41.2 kapitulli III, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”,

Situata:	Nga auditimi i monitorimit të buxhetit për vitet objekt auditimi u konstatua se Inspektorati Qendror nuk ka përgatitur raportet e monitorimit 4, 8, 12 mujore me relacione shpjegues të realizimit të treguesve me planin, si dhe masat korigjuese që duhet të ndërmerren për përmirësimin e situatës.
Kriteri:	Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”, pika 3.3/33 kapitulli III, Udhëzimi Plotësues Nr.2 datë 19.01.2018 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2018” dhe Udhëzimi Plotësues të Ministrit të Financave nr. 1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”
Ndikimi/Efekti:	Mos monitorimi i saktë çon në planifikim jo real të fondeve buxhetore.
Shkaku:	Mos pasja ne dispozicion te burimeve njezore per realizimin siç duhet te procesit të planifikim/monitorim të buxhetit
Rëndësia:	I mesëm

Pasqyra e performancës financiare pasqyron në mënyrë të klasifikuar dhe strukturuar informacionin për të ardhurat, shpenzimet, transfertat dhe operacionet që lidhen me rezultatin financiar të periudhës ushtrimore të mbyllur të krahasuar me periudhën e vitit të mëparshëm Të ardhurat paraqiten në rubrikën A të pasqyrës së performancës financiare. Totali i të ardhurave është i barabartë me shumën e totalit të të ardhurave nga taksat dhe tatimet, totalit të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, totalit të të ardhurave jo tatimore, totalit të të ardhurave financiare, totalit të granteve korrente, totali të të ardhurave të tjera si dhe ndryshimit të gjendjes së inventarit të produkteve. Për vitin 2018 institucioni nuk ka të ardhura parësore e as dytësore.

- Shpenzimet paraqiten në rubrikën B të pasqyrës së performancës financiare. Totali i shpenzimeve është i barabartë me shumën e totalit të shpenzimeve për pagat dhe përfitimet e punonjësve, totalit të shpenzimeve për kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, totalit të shpenzimeve për blerje të mallrave dhe shërbimeve, totalit të shpenzimeve për subvencione, totalit të shpenzimeve për transferime korrente, totalit të shpenzimeve financiare, totalit të shpenzimeve për kuota amortizimi dhe shuma të parashikuara, totalit të shpenzimeve që rrjedhin nga ndryshimi i gjendjes së inventarit si dhe totalit të shpenzimeve të tjera.

Vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare formati nr. 2 janë si më poshtë:

Nr.	Nr. Llogarije	P E R S H K R I M I I O P E R A C I O N E V E	VITI USHTRIMOR	VITI I MEPARSHEM
a	b	c	1	2
1	A	TE ARDHURAT	41,616,662	31,754,851
2	70	<i>1.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET</i>		
3	700	1.Tatimi mbi te Ardhurat		
8	702	2.Tatimi mbi Pasurine		
12	703	3.Tatime mbi mallrat e sherbimet brenda vendit		
18	704	4.Takse mbi tregtine dhe transaksionet nderkombtare		
23	705	5.Takse e rruges		
24	708	6.Te tjera Tatime e Taksa kombtare		
25	709	7.Gjoba e Kamat vonesa		



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “INSPEKTORATIN QËNDROR”

26	75	II.KONTRIBUTE SIGURIME SHOQERORE E SHENDETESORE		
34	71	III.TE ARDHURA JO TATIMORE		
47	719	3.Te tjera te ardhura jo tatimore		
48	76	IV.TE ARDHURA FINANCIARE		
53	72	V.GRANTE KORENTE	41,616,662	31,754,851
54	720	1.Grant korent I Brendshem	41,616,662	31,754,851
55	7200	Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)	35,357,359	29,679,968
61	7206	Financim I pritshe nga buxheti	6,259,303	2,074,883
64	721	2.Grant korent I Huaj		
67		VI.TE ARDHURA TE TJERA		
73	73	VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE		
74	B	SHPENZIMET	44,689,202	31,754,851
75	600	IPAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE	21,416,681	19,334,037
76	6001	Paga. personel I perhershem	21,416,681	19,334,037
77	6002	Paga personel I Perkohshem		
78	6003	Shperblime		
79	6009	Shpenzime te tjera per personelin		
80	601	II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	3,399,955	2,977,599
81	6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqerore	3,399,955	2,977,599
82	6011	Kontributi I Sigurimeve Shendetesore		
83	602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	12,859,094	11,677,248
84	602	Mallra dhe sherbime te tjera		
85	6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	2,942,602	3,271,729
86	6021	Materiale dhe sherbime speciale		
87	6022	Sherbime nga te trete	7,530,848	6,006,671
88	6023	Shpenzime transporti	1,620,069	1,215,939
89	6024	Shpenzime udhetimi	1,531,197	279,429
90	6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme		
91	6026	Shpenzime per qeramarrje		
92	6027	Shpenzime per detyrime per kompesime legale		
93	6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua		467,762
94	6029	Shpenzime te tjera operative	989,628	435,718
95	603	IV.SUBVECIONE	0	0
101		V.TRANSFERIME KORENTE	30,000	30,000
102	604	1.Transferime korente te brendshme	0	0
107	605	2.Transferime korente me jashte	0	0
108	6051	Transferime Per Organizatat Nderkombetare		
109	6052	Transferime Per Qeverite e Huaja		
110	6053	Transferime Per institucionet jo fitimprurese te huaja		
111	6059	Transferime Te tjera korrente me jashte shtetit		
112	606	3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe	30,000	30,000
113	6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH	30,000	30,000
114	6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor		
115		VI.SHPENZIME FINANCIARE		
116	65	1.Shpenzime Financiare te brendshme		
121	66	2.Shpenzime Financiare te jashtme		
125		VII.KUOTA AMORTIZIMI DHE SHUMA TE PARASHIKUARA	7,319,932	10,944,676
126	681	Kuota amortizimi te AAGJ te shfrytezimit	7,319,932	10,944,676
130	63	VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT	-336,460	-1,741,977



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “INSPEKTORATIN QËNDROR”

131		<i>IX.SHPENZIME TE TJERA</i>		-11,466,732
132	C/85	TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDHES (Rezultati I Veprimtarise se vitit (Ushtrimor)	-3,072,540	0

Në pasqyrën e performancës financiare, formati nr. 2 janë të pasqyruara shpenzimet korrente të konstatuara të ndara sipas zërave si

(600) “Paga, shpërblime e të tjera shpenzime personeli” në vlerën 21,416 mijë lekë ose 48% të totalit të shpenzimeve, për periudhën 01 janar deri 31 dhjetor 2018.

Llog. (601) “Kontribute për sig. Shoqërore e shëndetësore” në vlerën 3,399.9 mijë lekë ose 8 % të totalit të shpenzimeve,

Llog. (602) “Mallra dhe shërbime të tjera” në vlerën 12,859 mijë lekë ose 29 % të totalit të shpenzimeve, ku janë paraqitur të gjitha shpenzimet e kryera dhe të faturuara në vitin 2018.

Nga auditimi u konstatua se subjekti ka të regjistrua detyrimet për 12 muaj ndaj enteve publike për shërbime të marra të energjisë dhe ujit, të cilat janë kontabilizuar, ku pagesa e tyre është bërë brenda afateve ligjore .

Nga auditimi u konstatua se faturat e lëshuara për realizimin e shërbimeve dhe blerjen e mallrave nga të tretët janë rregjistruar dhe paguar brenda afatit ligjor prej 30 ditësh në sistemin e thesarit, nga data e marrjes prej debitorit të faturës, veprime në përputhje me Ligjin nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7.

Llog. (606) “Transferta për buxhete familjare e individët” në vlerën 30 mijë lekë

Llog. (63) “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në vlerën 336,460 lekë të paraqitur nga institucioni, e cila përfaqëson ndryshimin e gjendjes së inventarit në magazinën e materialeve dhe objekteve të inventarit të imët në përdorim të punonjësve, përputhet me diferencën e inventarit të pasqyruar në pasqyrën e pozicionit financiar të institucionit.

Rubrika C e pasqyrës së performancës financiare përfaqëson tepricën apo deficitin e periudhës (rezultatit e veprimtarisë së vitit ushtrimor të mbyllur) i cila është në shumën 3,072,540 lekë dhe është e barabartë me diferencën algjebrike midis totalit të të ardhurave dhe totalit të shpenzimeve. Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor të mbyllur, i paraqitur në rubrikën C të pasqyrës së performancës financiare është e barabartë me zërin rezultatit e veprimtarisë ushtrimore (llogaria 85), që evidentohet në rubrikën C, të aktiveve neto/fondeve neto në pasqyrën e pozicionit financiar.

Rezultati i veprimtarisë ushtrimore (llogaria 85) përfaqëson diferencën absolute midis totalit të operacioneve të të ardhurave (te ardhura të funksionimit + operacione të korigjimit) me totalin e operacioneve të shpenzimeve (shpenzimet e funksionimit + operacionet e korigjimit). Për kalimin në rezultat të të ardhurave sipas natyrës: është debituar llogaria e klasës 7 “Të ardhurat sipas natyrës” dhe është kredituar llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore”.

b) Për kalimin në rezultat të shpenzimeve korrente sipas natyrës është debituar llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” dhe është kredituar llogaria e klasës 6 “Shpenzimet sipas natyrës”

Nga grupi i auditimit u bë rakordimi i shpenzimeve të pasqyrës nr. 2 me thesarin ku konstatohet se: Vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare formati nr. 2 përputhen me vlerat e paraqitura në akt rakordimit me degën e thesarit “Mallra dhe shërbime të tjera”, sipas bilancit paraqiten në vlerën 12,859,094 lekë, ndërsa sipas akt rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 12,689,094 lekë, ku diferenca prej 170,000 lekë vjen si rezultat i një fature të paguar të konstatuara në 2018 dhe që do paguhet në periudhat e ardhshme.

Rezulton se pagesat e realizuara në janar për efekt të buxhetit të vitit që u mbyll, janë konstatuar si detyrime ndaj të tretëve me 31 Dhjetor 2018.

Paga, shpërblime e të tjera personeli sipas bilancit paraqiten në vlerën 21,416,681 lekë, ndërsa sipas akt rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 21,329,239 lekë, ku diferenca prej 87,442 lekë vjen si rezultat diferencës së pagës dhjetor 2018 (të konstatuara në 2018 dhe paguar në 2019 me atë të dhjetor 2017 të konstatuara në 2017 dhe paguara në janar 2018. E njëjti fenomen ndodh dhe me llogarinë 601” Kontributeve e sig. shoq. e shëndetësore” sipas bilancit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “INSPEKTORATIN QËNDROR”

paraqiten në vlerën 3,399,955 lekë, ndërsa sipas akt rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 3,383,493 lekë, ku diferenca prej 16,462 lekë vjen si rezultat diferencës së kontributeve të dhjetor 2018 (të konstatuara në 2018 dhe paguar në janar 2019) me atë të dhjetor 2017 (të konstatuara në 2017 dhe paguara në janar 2018).

Pasqyra krahasuese si më poshtë:

Në lekë

Nr. Llog	Shpenzimet e ushtrimit	Pasqyrat financiare	Rakordimi me thesarin	Diferenca
60	I. Shpenzime Korrente	39,460,979	37,431,826	273,904
600	Paga, shpërblime e të tjera personeli	21,416,681	21,329,239	87,442
601	Kontrib.te sig.shoq.e shendets.	3,399,955	3,383,493	16,462
602	Mallra dhe shërbime te tjera	12,859,094	12,689,094	170,000
605	Transferta korente me jashtë			0
606	Transferta për buxh. familjare e individë	30,000	30,000	0

- Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave viti 2018-30.08.2019

Administrata e Inspektoriatit Qendror zhvillon aktivitetin e saj në zbatim të rregullores së brendshme e cila është miratuar me urdhër nr.25, datë 10.08.2018 “Për Miratimin e Rregullores, Për Përcaktimin e Procedurës së Inspektiveve, si një proces i rregullt Administrativ.

Struktura dhe organika e Inspektoriatit Qendror është krijuar me Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si institucion qendror, buxhetor në varësi të Kryeministrit dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.630, datë 14.09.2011.

Emërimi i personelit të institucionit, është bërë në zbatim të ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” si dhe në bazë të Urdhërit të nr.24, datë 03.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së IQ. Organika dhe struktura e institucionit aktualisht përfshin 25 punonjës. Në zbatim të VKM-së nr.208, datë 24.04.2018, “Për shpërndarjen e punonjësve organik pëe njësitë e qeverisjes qendrore për vitin 2018”, Sektori i Teknologjisë së Informacionit, i kaloi Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, duke e lënë të pambuluar këtë sektor. Gjatë gjithë kësaj periudhe, ky sektor është i mbuluar vetëm nga një specialist..

Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve

IQ aktualisht ka 25 punonjës, ku nga shqyrtimit i dosjeve personale të punonjësve, rezultoi se pozicioni i punës që ato ushtrojnë përputhet me kualifikimin e tyre. Përcaktimi i pagave është bërë në përputhje me VKM nr. 187, datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve” VKM nr. 736, datë 09.09.2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-së nr. 545, datë 11.08.2011 “Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zv.ministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, KQZ, Prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të KM, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefketit”, të ndryshuar.”; si dhe VKM nr. 202, datë 15.03.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 717, datë 23.06.2009, “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, i ndryshuar.

Nga auditimi me përzgjedhje i listë pagesave të vitit 2018 dhe 8 mujorit 2019, rezultoi që kishte përputhshmëri në përlllogaritjen e pagave të punonjësve me pozicione të ndryshme, konkretisht :

- 1- Drejtor Drejtorie
- 2- Përgjegjës sektori
- 3- Specialist

- Respektimi i dispozitave ligjore për kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale.

Nga auditimi i kryer me zgjedhje, për respektimin e dispozitave ligjore për sigurimet shoqërore dhe tatimin mbi të ardhurat personale, rezultoi se për periudhën objekt kontrolli janë zbatuar dispozitat ligjore që rregullojnë këtë fushë konkretisht: Derdhja dhe likuidimi i kontributeve –



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “INSPEKTORATIN QËNDROR”

artikulli 601 është bërë në përputhje me Ligjin nr. 184/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10383, datë 24.02.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në RSH”, si dhe VKM nr. 77, datë 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor” dhe VKM nr. 399. Datë 03.05.2017 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vend” dhe ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar Nga auditimi u konstatua përputhshmëri midis vlerës në total të kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore me vlerën e paraqitur në pasqyrat financiare

1.3. Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si edhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare

Pasqyra e pozicionit financiar pasqyron në mënyrë të klasifikuar e strukturuar aktivet, detyrimet dhe fondet neto të subjektit në datën e përcaktuar për mbylljen e vitit ushtrimor raportues, nga data 1 Janar deri më 31 Dhjetor të vitit 2018.

Në lekë

Nr.	Referenca e llogarive	Emërtimi	Ushtrimi I mbyllur	Ushtrimi paraardhës
1	A	A K T I V E T	135,075,112	153,537,850
2		I. Aktivet Afat shkurtra	7,590,628	3,254,696
3		I. Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre	453,570	638,519
4	531	Mjrete monetare ne Arke		
5	512,56	Mjrete monetare ne Banke		
6	520	Disponibilitete ne Thesar	453,570	638,519
11		2. Gjendje Inventari qarkullues	877,755	541,295
12	31	Materiale	877,755	541,295
13	32	Inventar I imet		
16	35	Mallra		
21		3. Llogari te Arketushme	6,259,303	2,074,882
22	411	Kliente e llogari te ngjashme		
23	423,429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba		
31	465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere		
32	468	Debitore te ndryshem		
33	4342	Operacione me shtetin (Te drejta)	6,259,303	2,074,882
36		4.Te tjera aktive afatshkurtra	0	0
42		II. Aktivet Afat gjata	127,484,483	150,283,155
43	20	I.Aktive Afatgjata jo materiale	0	23,003,347
44	201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
45	202	Studime dhe kerkime		
46	203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme		23,003,347
47	21	2. Aktive Afatgjata materiale	51,266,933	63,046,508
48	210	Toka, T,roje, Terene	5,201,480	5,201,480
49	211	Pyje, Plantacione		
50	212	Ndertesa e Konstruksione	9,813,260	10,329,747
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore		
52	214	Instalime teknike, makineri e paisje	4,523,297	5,945,227
53	215	Mjete Transporti	12,977,492	16,221,866
56	218	Inventar ekonomik	18,751,404	25,348,188
57	24	Aktive afatgjata te demtuara		
58	28	Caktime te Aktiveve Afatgjata		
59	25-26	3. Aktive Afatgjata Financiare	0	0
62		4.Investime	76,217,550	64,233,300



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “INSPEKTORATIN QËNDROR”

	230	Per aktive afatgjata jomateriale	27,220,800	27,220,800
	231	Per aktive afatgjata materiale	48,996,750	37,012,500
65	B	PASIVET(DETYRIMET)	6,259,302	2,911,646
66		I. Pasivet Afat shkurtra	6,259,302	2,911,646
67		I. Llogari te Pagushme	6,259,302	2,911,646
68	401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	3,652,702	223,584
69	42	Detyrime ndaj personelit	1,341,295	1,273,042
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
71	460	Huadhenes		
72	431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	153,347	146,581
73	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqerore	515,545	486,661
76	436	Sigurime Shendetsore		
81	466	Kreditore per mjete ne ruajtje	593,254	778,619
82	467	Kreditore te ndryshem	3,159	3,159
83	4341	Operacione me shtetin(detyrime		
84	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
85		2.Te tjera pasive afatshkurtra	0	0
86	419	Kreditore, Parapagime		
87	475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese		
88	478	Diferenca konvertimi pasive		
89	480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		
90	487	Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se titullit		
91		II. Pasivet Afat Gjata	0	0
92	Klase 4	Llogari te pagushme		
93	16.17,18	Huate Afat gjata		
94		Provigjonet afatgjata		
95	Klasa 4	Te tjera		
96	C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	128,815,810	150,626,204
97	D	FONDI I KONSOLIDUAR :	128,815,810	150,626,204
98	101	Teprica (Fondi I akumuluar)/ Deficiti I akumuluar	278,883,155	254,867,671
99	12	Rezultatet e mbartura		
100	85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	-3,072,538	
103	105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshme	-147,553,007	-104,799,667
104	106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja	558,200	558,200
108	E	TOTALI I PASIVEVE(B+C)	135,075,112	153,537,850

Aktivet paraqiten në rubrikën A të pasqyrës së pozicionit financiar. Totali i aktiveve përbëhet nga shuma e totalit të aktiveve afatshkurtra dhe totalit të aktiveve afatgjata. Rubrika I e aktiveve, që përfaqëson aktivet afatshkurtra, përbëhet nga shuma e nënrubrikave që përfaqësojnë: mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, gjendje inventari qarkullues, llogari të arkëtueshme dhe të tjera aktive afatshkurtra.

Llogaria 520 “Disponibilitete ne Thesar” në shumën 453,570 lekë e cila përbëhet nga vlera e 5 % garanci punimesh e cila duhet të jetë e barabartë me 466 “Kreditore per mjete ne ruajtje”. Por në celjen e 2018 është bërë një gabim në celje e cila është sistemuar në vitin 2019.

- Llogaria 31 “Materiale”, paraqitet në vlerën 877,755 lekë dhe në krahasim nga viti paraardhës është me rritur në shumën 336,460 lekë lekë. Kjo llogari përfaqëson materiale pastrimi, materiale kancelari, tonera dhe karta inspektorësh.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “INSPEKTORATIN QËNDROR”

- Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin”, në vlerë prej 6,259,303 lekë përfaqëson paga e sigurime të personelit për tu paguar në Janar të vitit 2019. detyrimet për tu paguar për sigurimet shoqërore e shëndetësorë, pra janë shpenzime të vitit 2018, që do të paguhen në vitin 2019, si dhe shuma kreditorë të ndryshëm. Janë burime financimi për detyrimet afatshkurtër gjendje (kryesisht të muajit Dhjetor), që sipas Ligjit të Buxhetit mbulohen nga buxheti i vitit pasardhës. Gjithashtu në këtë vlerë përfshihen dhe shuma e angazhimeve të konstatuar në vitet paraardhëse dhe që do shlyhen në 2019. Nga analiza e rezulton që është përfshire dhe llogaria 466 -“Kreditore për mjete ne ruajtje”, për të cilën institucioni i ka fondet në dispozicion në llogarinë 520 “Disponibilitete ne Thesar”veprim i cili është sistemuar për në 2019.
- Llogaria 210 “Toka, T,roje, Terene” ka të bëjë me vlerën e investimit të realizuar për pastrimin, sistemimine ambjenteve të jashtme të institucionit.
- Llogaria 212 “Ndërtime e konstruksione”, paraqitet në fund të vitit 2018 në vlerën neto 9,813,260 lekë. Kjo vlerë është rikonstruksioni i godinës së institucionit, i cili është në përdorim në zbatim të VKM-së.nr.473 datë 25.07.2012, dhe në administrim të Institutit të Gjeoshkencës, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit.
- Llogaria 215 “Mjete Transporti”, paraqitet në fund të vitit 2018 në vlerën neto 12,977,492 lekë ku kosto historike është në shumën 17,395,000 lekë dhe përfaqëson vlerën e 6 automjeteve në dispozicion të IQ si dhe amortizimi I akumuluar në shumën 17,395,000 lekë.
- Llogaria 218 “Inventar ekonomik”, paraqitet në fund të vitit 2018 në vlerën neto/kosto historike 18,7514,403 lekë, ku vlera bruto është në shumë 31,105,125 lekë dhe amortizimi i akumuluar në shumën 12,353,722 lekë.

Gjatë vitit 2018 janë bërë transferime kapitale të aktiveve nga institucioni tek AKSHI.

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 ‘Për menaxhimin financiar dhe kontrollin’, i ndryshuar të shkronjës “b”, të pikës 2, të VKM-së nr.153, datë 03.04.1993, “Për kalimin e objekteve, të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore”, udhëzimi nr.30,datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik, i ndryshuar dhe VKM nr.673,datë 22.11.2017 “Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” i ndryshuar, IQ me anë të shkresës nr.440 Prot, datë 02.07.2018, i drejtohet AKSHI-t me shkresën nr.3120 Prot, datë 02.07.2018, për një urdhër të përbashkët me qëllim:

1. Ngritja e grupeve të punës për përcaktimin e listës së aktiveve për infrastrukturën dhe sistemeve IT, objekt kalimi kapital, si dhe identifikimin dhe propozimin e të drejtave dhe detyrimeve të institucioneve në lidhje me shërbimet ulitare.

2. Të ngarkohet Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Financës , në IQ, dhe Sektori i Financës në AKSHI dhe Grupet e Punës për zbatimin e këtij urdhëri dhe kryerjen e veprimeve përkatëse për dorëzimin dhe marrjen në dorëzim të aktiveve për infrastrukturën hardëeare dhe sistemeve

Me Akt-dorëzimin nr.440\2 Prot, datë 09.10.2018, i mbajtur nga Inspektorati Qendror, dhe me shkresën nr.5379 Prot, datë 09.10.2018 i është dorëzuar Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dorëzimi fizik të Aktiveve për infrastrukturën hardware dhe sistemeve IT, e mbajtur në prezencën e komisioneve nga te dy institucionet e lartë përmendura, në vlerën historike 67,158,662 lekë dhe në vlerën kontabël neto 29,268,557,44 lekë. Këtij akt-dorëzimi i është bashkëlidhur:

1. Fletë dalje nr.107, datë 09.10.2018
2. Pasqyra e amortizimeve ndër vite.
3. Fotokopje të faturave tatimore për këto sisteme.

Amortizimi vjetor është llogaritur dhe kontabilizuar sipas normave të përcaktuara në udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësinë e qeverisjes së përgjithshme”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “INSPEKTORATIN QËNDROR”

Llogaria 230-231: Fillimisht njësia për këto investime ka planifikuar dhe realizuar operacionet për blerjen apo krijimin e AAGJ-ve. Këto aktive afatgjata, para se të vihen në shfrytëzim, pra të jenë funksionale ato detyrimisht duhet të gjenden në proces, në formën e shpenzimeve që grupohen me analiza në llogarinë 23 “Investime”. Por këto investime nuk janë në proces, janë investime të përfituara dhe të marra në dorëzim nga institucioni, që ka të bëjë me shërbimin e mirëmbajtjes së sistemit të Inspektoratit i cili ka pasë kontratë 4- vjecare, e cila ka përfunduar në janar të 2018.

Institucioni në fund të periudhës ushtrimore të vitit 2018 duhet ti kapitalizonte në grupet 20 e 21 të aktiveve të përfunduara. Po ky sistem ka kaluar në pronësi të AKSH, me Akt-dorëzimin nr.440\2, datë 09.10.2018, ku dhe vlera e mirëmbajtjes duhet të ishte kapitalizuar në llogarinë 20 e 21 dhe të ishte kaluar si pjesë e sistemit tek AKSHI.

Formati 7/b “Pasqyra e amortizimeve”, nga auditimi rezulton se është plotësuar sipas Udhëzimit të MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Situata:	Nga auditimi i llogarisë 230 “Per aktive afatgjata jomateriale” në vlerën 27,220,800 lekë dhe llogarisë 231 “Per aktive afatgjata materiale” në vlerën 48,996,750 lekë, të cila kanë të bëjnë me aktive afatgjata, para se të vihen në shfrytëzim, pra para se këto aktive të jenë funksionale ato detyrimisht duhet të gjenden në proces, në formën e shpenzimeve që grupohen me analiza në llogarinë 23 “Investime”. Nga analiza e zërave të investimit dhe kapitalizimit të tyre u konstatua se këto investime nuk janë në proces, janë investime të përfituara dhe të marra në dorëzim nga institucioni, të cilat kanë të bëjnë me shërbimin e mirëmbajtjes së sistemit të Inspektoratit, në bazë të kontratës 4-vjecare me nr. 130/1, datë 01.01.2014 deri me datën 31.12.2017 dhe amendimit nr. 702, datë 28.12.2017 për shtesë kontrate. Institucioni në fund të periudhës ushtrimore të vitit 2018 duhet ti kapitalizonte në grupet 20 e 21 të aktiveve të përfunduara dhe vlera totale prej 76,217,550 lekë duhet të kalonte e kapitalizuar bashkë me sistemin te AKSHI, me Akt-dorëzimin nr.440\2, datë 09.10.2018.
Kriteri:	Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësinë e qeverisjes së përgjithshme”, VKM-së nr .673, datë 22.11.2017 “Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit pikave 18-20.
Ndikimi/Efekti:	Mos pasqyrim i saktë i zerave në pasqyrën financiare.
Shkaku:	Veprime kontabël të trashëguara që nga viti 2013, të cilat nuk janë sistemuar.
Rëndësia:	I mesëm

Pasivet (detyrimet) pasqyrohen në Rubrikën B të pasqyrës së pozicionit financiar. Totali i pasiveve përbëhet nga shuma e totalit të pasiveve afatshkurtra dhe totalit të pasiveve afatgjata.

Rubrika e I-rë përfaqëson pasivet afatshkurtra, e cila përbëhet nga detyrimet si psh: furnitorë, detyrime ndaj personelit, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, kreditorë të ndryshëm.

Llogaria 401-408 “Furnitore e llogari te lidhura me to” në shumën prej 3,652,702 lekë është shuma e detyrimeve të konstatuar në vitin 2018 për:

- Ikub dhe Infosoft system për realizimin e shërbimit të mirëmbajtjes së sistemit për shumën 3,482,702 dhe për furnizimin me tableta në shumën prej 170,000 lekë.

Llogaria 42 “Personeli dhe llogari të lidhur me to“ në vlerën 1,341,295 lekë, përfaqëson pagat e muajit Dhjetor 2018, ndërsa llogaria 431 në shumën prej 153,347 lekë përfaqëson tatimin e pagave të muajit Dhjetor 2018 të cilat likuidohen në Janar të vitit 2019.

Llogaria 435 & 436 “Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore“ në vlerën 515,545 lekë, përfaqëson kontributin e sigurimit shoqëror dhe e sigurimit shëndetësor të muajit Dhjetor 2018, e cila likuidohet në muajin Janar 2019.

- Llogaria 466 “Kreditorë për mjete ne ruajtje” në vlerën 593,254 lekë përfaqëson 5% garanci punimesh, e cila duhet të jetë e barabartë me tepricën e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe të vërtetohen me aktrakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkangjitet llogarisë vjetore.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “INSPEKTORATIN QËNDROR”

Në aktrakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara.

- Llogaria 467” Kreditore të ndryshëm (kreditore për investime) “ në shumën prej 3,159 lekë të mbartur nga periudha paraardhëse, ka të bëjë me sistemim në lidhje me detyrimet për sigurime suplementare..

Rubrika C e pasqyrës së pozicionit financiar evidenton aktivet neto ose fondet neto. Fondet neto përbëjnë diferencën midis totalit të aktiveve me totalin e pasiveve. Fondet neto përfshijnë zëra si: Llogaria (101) finalizohen në kontabilitet, si burime, gjithçka që ka ndodhur me kapitalizimin në fonde të aktiveve si dhe të gjitha lëvizjet dhe ndryshimet që kanë ndodhur në aktivet e njësisë së qeverisjes së përgjithshme.

Llogaritë e tepricës së granteve kapitale të brendshme (105) dhe tepricës së granteve kapitale të huaja (llogaria 106)

Tepricës së granteve kapitale të brendshme (105) është si më poshtë:

a) Llogaritë 1050, 1051 e 1052, që përfaqësojnë grante kapitale dhe kontribute të të tretëve për investime të cilat kanë marrë në kredi vlerën e këtyre granteve, me kundërparti debitin e llogarisë 476 ”Të ardhura të caktuara për t’u përdorur” ose të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar”, kur nuk tranzitohen veprimet nga llogaria 476.

b) Llogaritë 1059 ”Grante kapitale të brendshme në natyrë” marrin në kredi vlerën e aktiveve të dhuruara nga transferimet e brendshme apo donatorë të huaj (të marra në dorëzim dhe të bëra hyrje në institucion), në debi të llogarive përkatëse të aktiveve (20 dhe 21).

Llogaritë 105 mbeten me tepricë në fund të periudhave ushtrimore vetëm në rastet kur këto grante janë burim për investimet në proces të institucioneve (të papërfunduara ose të pamarra në dorëzim).

Por institucioni i ka marrë në dorëzim dhe i ka kapitalizuar në llogarinë 21, pra nuk ka të bëjë me investime në proces. *Në fund të periudhës institucioni duhet të bënte verpimin e mbylljes me fondet bazë në kohën kur investimi është përfunduar dhe marrë në dorëzim. Kjo situatë vjen e trashëguar që nga viti 2013.*

Llogaria 106 “Grante kapitale të huaja në natyrë” merr në kredi vlerën e aktiveve të dhuruara nga transferimet e brendshme apo donatorë të huaj (të marra në dorëzim dhe të bëra hyrje në institucion), në debi të llogarive përkatëse të aktiveve (20 dhe 21).

Llogaritë 106 mbeten me tepricë në fund të periudhave ushtrimore vetëm në rastet kur këto grante janë burim për investimet në proces për institucionin (të papërfunduara ose të pamarra në dorëzim). Në aktiv të bilancit këto janë investime në proces në grupin e llogarive 23. Por institucioni i ka marrë në dorëzim dhe i ka kapitalizuar në llogarinë 21, pra nuk ka të bëjë me investime në proces. *Në fund të periudhës institucioni duhet të bënte verpimin e mbylljes me fondet bazë në kohën kur investimi është përfunduar dhe marrë në dorëzim. Kjo situatë vjen e trashëguar në vite.*

Si dhe llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor të mbyllur”, i paraqitur në rubrikën C të pasqyrës së performancës financiare.

Situata:	Nga auditimi i zërave të pasqyrës së ndryshimeve të aktivet neto/ fondet neto dhe të pasqyrës së pozicionit financiar rubrika C u konstatua se, llogaria 105 “Teprica e Granteve kapitale të Brendshme” dhe llogaria 106 “Teprica e Granteve kapitale të Huaja” rezultojnë me tepricë në fund të periudhave ushtrimore, çka do të thotë se këto grante janë burim për investimet në proces për institucionin (të papërfunduara ose të pamarra në dorëzim). Por nga analiza e zërave të pasqyrës nuk rezulton që institucioni të ketë investimet në proces (të papërfunduara ose të pamarra në dorëzim). IQ-rë i ka marrë në dorëzim të gjitha investimet e realizuara në vite dhe i ka kapitalizuar në llogarinë 21. Pra rezulton se institucioni në fund të periudhës kontabël nuk ka bërë veprimin e mbylljes duke debituar 105 “Teprica e granteve kapitale të brendshme” ose 106 “Teprica e granteve kapitale të huaja”; dhe kredituar llogarinë 1011 “Shtesa në fondet bazë”.
-----------------	--



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “INSPEKTORATIN QËNDROR”

Kriteri:	udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësinë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 1.1 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i klasës 1”
Ndikimi/Efekti:	Mos pasqyrim i saktë i zërave në pasqyrën financiare.
Shkaku:	Veprime kontabël të trashëguara që nga viti 2013, të cilat nuk janë sistemuar.
Rëndësia:	I mesëm

1.4. Pasqyra e fluksit tëi mjeteve monetare

Pasqyra financiare e flukseve monetare jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet në mjetet monetare apo ekuivalentet e tyre (llogaritë financiare të klasës 5). Në fund të pasqyrës jepen të dhënat në lidhje me shtimin apo pakësimin neto të mjeteve monetare të njësisë, të shkaktuar nga kryerja e veprimtarive të njësisë gjatë vitit ushtrimor të mbyllur.

Në lekë

Nr. Reshti	Nr Rubrike	PERMBAJTJA	Periudha Raportuse	Periudha Paraardhese
(a)	(b)	(c)	(1)	(2)
1	I	VEPRIMTARITE E SHFRYTEZIMIT	4,530,061	13,930,471
2	1	Akordim Fonde Buxhetore per shpenzime korente (+)	41,961,888	46,000,000
3	2	Arketime e te hyra(Cash), gjate vitit ushtrimor	0	0
4		Te Hyra nga Tatimet e Doganat tatimore e Doganore(+)		
5		Te hyra nga Kontributet e Sig. shoq. e shendets(+)		
6		Te hyra nga ardhurat jotatimore (+)		
7		Te hyra, Sponsorizime nga te trete,(+)		
8		Te hyra, nga kredi e huamarrje afatshkurter(+)		
9		Te hyra nga Mjetet ne ruajtje(+)		
10		Te tjera, arketuar(+)		
11	3	Pagesa per Detyrime e Shpenzime korente	-37,431,827	-32,069,529
12		Per detyrime e Shpenzime nga vitet e kaluara(-)		
13		Per detyrime e Shpenzime te viti ushtrimor(-)	-37,431,827	-32,069,529
14		Pagesat per mjetet ne ruajtje(-)		
15		Interesi I paguar(-)		
16		Tatime te paguara(-)		
17		Te tjera te paguara (-)		
18	II	VEPRIMTARITE E INVESTIMEVE	0	1,044,195
19		Akordim Fonde Buxhetore per shpenzime Kapitale (+)	24,015,484	61,004,000
20		Te hyra nga Kredi dhe e huamarrje afatgjata(+)		
21		Te hyra nga shitja e Aktiveve Afatgjata (+)		
22		Te hyra nga interesat e huadhenies dhe nenhuadhenies(+)		
23		Pagesa per detyrime e Investime nga vitet e kaluara(-)	-223,584	
24		Per detyrime e Investime te viti ushtrimor(-)	-23,791,900	-59,959,805
25		Huadhenie e Nenhuadhenie(-)		
26		Pjesmarrje ne kapitalin e vet(-)		
27		Dividente te paguar(-)		
28	III	TRANSFERTA E TE TJERA	-4,345,113	778,619
29		Derdhje e Transferime te te Ardhurave ne Buxhet(-)		
30		Transferime ne buxhet te Fondeve te perdorura(-)	-4,530,478	140,100
31		Levizje e brendshme e transferata te tjera (+-)	185,365	638,519
32	IV	Rritja /Renia neto e Mjeteve monetare	184,948	15,753,285
33	V	Teprica ne fillim te vitit ushtrimor	638,519	
34	VI	Teprica e Likuiditeteve ne fund te vitit ushtrimor	453,570	638,519

Rubrika një pasqyron flukset e mjeteve monetare që rrjedhin nga veprimtaritë e shfrytëzimit të njësisë. Totali i flukseve të mjeteve monetare që rrjedhin nga veprimtaritë e shfrytëzimit është i



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “INSPEKTORATIN QËNDROR”

barabartë me shumën e totalit të zërave: akordim fondesh buxhetore për shpenzime korrente, arkëtime e të hyra gjatë vitit ushtrimor dhe pagesa për detyrime e shpenzime korrente.

Nënrubrika “akordim fondesh buxhetore për shpenzime korrente” përfaqëson flukse monetare hyrëse që rrjedhin nga akordimet e fondeve buxhetore për shpenzime korrente në shumën prej 41,961,888 lekë.

Nënrubrika “Pagesa për detyrime e shpenzime korrente” përbëhet nga shuma e zërave si: pagesa për detyrime e shpenzime nga vitet e kaluara, për detyrime e shpenzime të vitit ushtrimor, interesi i paguar, tatime të paguara, pagesat për mjetet në ruajtje si dhe të tjera të paguara.

Rubrika II pasqyron flukset monetare nga veprimtaritë e investimeve të njësisë, ku përbëhet nga zëra si: akordim fondesh buxhetore për shpenzime kapitale, pagesa për detyrime e Investime te viti ushtrimor (-), si dhe pagesa për detyrime e Investime nga vitet e kaluara (-).

Rubrika III pasqyron flukset monetare nga transfertat dhe transaksionet si: derdhje e transferime të të ardhurave në buxhet, transferime në buxhet të fondeve të përdorura dhe lëvizje e brendshme e transfertat të tjera, që përfaqëson 5% garanci mjete ne ruajtje

Rubrika IV përfaqëson shtimin neto të mjeteve monetare në krahasim me vitin paraardhës

Rubrika V dhe rubrika VI përfaqësojnë respektivisht gjendjen e mjeteve monetare në fillim dhe në fund të vitit ushtrimor të mbyllur, të barabarta më vlerën e paraqitur në pasqyrën nr. 1 të “Pozicionit financiar”, ku diferenca algjebrike e këtyre rubrikave është e barabartë me shumën e evidentuar në rubrikën IV.

1.5. Formati “Pyetësor dhe shënime shpjeguese”: është plotësuar relacioni shpjegues për pasqyrat financiare dhe janë përfshirë informacionet shpjeguese që kërkohen, në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar ku jepen informacionet shpjeguese të nevojshme për të arritur paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Dhënia e shënimeve shpjeguese të pasqyrave financiare vjetore nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme është bërë sipas formatit të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të emërtuar: “Pyetësor dhe shënime shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore”,

1.6. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto

Pasqyra financiare individuale e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve dhe fondeve neto të njësisë së qeverisjes së përgjithshme gjatë vitit ushtrimor të mbyllur (raportues). Në këtë pasqyrë financiare është evidentuar :

- Shumat përkatëse për gjendjen e fondeve/aktiveve neto në fillim të periudhës ushtrimore, për çdo zë, ndryshimet në aktivet/fondet neto, që rrjedhin nga burime të brendshme (nga grantet e brendshme kapitale, transfertat e brendshme të AAGJ-së, dhurata në natyrë, nga shitjet e AAGJ-së, nga rezultate e mbartura, nga rezervat etj.), si dhe nga burime të jashtme (nga grantet e jashtme kapitale dhe transfertat e brendshme të AAGJ-së, dhurata në natyrë).

Në fund të pasqyrës është pasqyruar totali i fondeve të veta për çdo zë të pasqyruar.

Totali i fondeve të veta të kësaj pasqyre është i barabartë me totalin e aktiveve/fondeve/neto të evidentuar në pasiv të pasqyrës financiare.

Çeljen e vitit ushtrimor, llog. 101 “Fonde bazë” në shumën 254,967,671 lekë e pasqyruar edhe në pasivin e bilancit llog. 101 “Fonde bazë”;

Teprica në fund e llog. 101, është e njëjtë me tepricën e saj në pasiv të bilancit kontabël, pasqyra nr. 2 në vlerën 275,810,615 lekë.

Në lëvizjet gjatë periudhës ushtrimore në debi dhe kredi të kësaj llogarie rezultoi se :

Llogaria 1011, “Shtesa të fondit bazë” është kredituar për vlerën e aktiveve të blera apo të krijuara në njësinë e qeverisjes së përgjithshme (për aktivet e marra në dorëzim) me kundërparti debitin e llogarive përkatëse të burimeve (105, 106 dhe 115) përkatësisht;

Llogarisë 1011, “Shtesa në fondet bazë” i është shtuar dhe ndikimin pozitiv i ndryshimit të gjendjeve të inventarit në fund të vitit ushtrimor në shumën prej 335,460 lekë

Llogaria 1013, “Pakësim fondesh nga amortizimi i AAGJ-së”ka merrë në debi amortizimin



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “INSPEKTORATIN QËNDROR”

vjetor të aktiveve afatgjata me kundër-parti kreditimin e llogarisë 209 e 219 “Amortizimi i aktiveve afatgjata”

Llogaritë 105 ka mbetur me tepricë në fund të periudhave ushtrimore pasi institucioni në fund të periudhës nuk ka bërë verpimin e mbylljes me fondet bazë në kohën kur investimi është përfunduar dhe marrë në dorëzim. Kjo situatë vjen e trashëguar që nga viti 2013.

Llogaritë 106 ka mbetur me tepricë në fund të periudhave ushtrimore pasi institucioni në fund të periudhës nuk ka bërë verpimin e mbylljes me fondet bazë në kohën kur investimi është përfunduar dhe marrë në dorëzim. Kjo situatë vjen e trashëguar në vite.

Totali i fondeve të veta të kësaj pasqyre është i barabartë me totalin e aktiveve/fondeve neto të evidentuar në rubrikën C të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar.

Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave në përputhje me rregullat kontabël

Nga auditimi u konstatua se Inspektoriati Qendror ka të dhëna mbi gjendjen fizike dhe vlerën kontabël të pronave në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, neni 26 ku citohet: “Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësoj një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike që siguron të ardhur ...” dhe neni 31, citohet “...për objektet e dhëna me qira – sipërfaqja e objektit në m², numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës...”

Komisioni i ngritur me urdhër të titullarit të IQ nr. 02, datë 07.01.2019 “Për kryerjen e inventarizimit të përgjithshëm për gjendje deri në 31.12.2018 ” ka bërë verifikimin fizik të gjendjes së aktiveve në përdorim të personelit.

Nga auditimi u konstatua se, nga komisioni para fillimit të inventarit nuk ishte fiksuar numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljeve nëpërmjet një procesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit, në kundërshtim me pikën 83 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Në fund të procesit të inventarizimit, komisioni nuk kishte përpiluar një raport në lidhje me inventarizimin fizik të aktiveve, ku të japë komentet në lidhje me gjendjen fizike aktuale të aktiveve (nëse janë apo jo në përdorim), si dhe për kushtet e ruajtjes së tyre dhe së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzonte për veprime të mëtejshme titullarit të institucionit, veprime në kundërshtim me pikën 85/c të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011.

Për vitet objekt auditimi u konstatua se komisioni i inventarizimit nuk ka bërë një vlerë totale me listë të bashkëngjitur, se sa ka gjendje fizike institucioni, për pajisje informatike, për pajisje zyre të ndarë në artikuj, si dhe mjete transporti në dispozicion etj sipas formatit të regjistrit të aktiveve, i cili hartohet në vartësi të llojit të tyre, si dhe grupit përkatës brenda llojit dhe më pas të bëhej krahasimin gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të regjistruara në kontabilitet, për të vërtetuar nëse eksitojnë apo jo diferenca, veprime në kundërshtim me pikat 30, 73, 74 , pika 81 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Situata:	Nga auditimi i inventarizimit të aktiveve të realizuar sipas urdhërit të titullarit të IQ nr. 02, datë 07.01.2019 “Për kryerjen e inventarizimit të përgjithshëm për gjendje deri në 31.12.2018 ”, sipas të cilit është ngritur komisioni për inventarizimin fizik të aktiveve dhe vlerësimin e tyre, në zbatim të nenit 12, pika 2 b dhe nenit 15 pika 4 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pikat 73, 74 dhe pika 81 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe nenit 7 të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” u konstatua se në fund të procesit të inventarizimit komisioni nuk ka përpiluar një raport në lidhje me inventarizimin fizik të aktiveve, ku të japë komentet në lidhje me gjendjen fizike aktuale të
-----------------	--



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “INSPEKTORATIN QËNDROR”

	aktiveve (nëse janë apo jo në përdorim), si dhe për kushtet e ruajtjes së tyre dhe së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzonte për veprime të mëtejshme titullarit të institucionit - Nga auditimi u konstatua se para fillimit të inventarit nuk ishte vendosur numri rendor i fletë hyrjes dhe i fletë daljes nëpërmjet një procesverbal, i cili mbahet midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit - Për vitet objekt auditimi u konstatua se komisioni i inventarizimit nuk ka nxjerrë një vlerë totale dhe listë të detajuar, se sa ka gjendje fizike institucioni, për pajisje informatike, për pajisje zyre të ndarë në artikuj, si dhe mjete transporti në dispozicion etj., sipas formatit të regjistrit të aktiveve, i cili hartohet në vartësi të llojit të tyre, si dhe grupit përkatës brenda llojit dhe më pas të bëhej krahasimin gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të regjistruara në kontabilitet, për të vërtetuar nëse ekzistojnë apo jo diferenca,
Kriteri:	Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pikat 30, 73, 74, 81, 83 dhe 85/c të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe nenit 7 të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.
Ndikimi/Efekti:	Mos monitorim i gjendjes reale të aktiveve në dispozicion, si dhe nevojave të institucionit për asete shtesë.
Shkaku:	Mos rakordim nga komisioni i çdo zëri të asetëve me regjistrin kontabël.
Rëndësia:	I mesëm

2 VLERËSIMI I FUNKSIONIMIT TË SISTEMEVE TË MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT

Në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, në bazë të këtij ligji u krye vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në Inspektoratin Qëndror.

Në kuptimin e këtij ligji, menaxhimi dhe kontrolli financiar përcaktojnë përgjegjshmërinë menaxheriale për planifikimin, zbatimin dhe kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin, për të arritur objektivat dhe për të shmangur shpërdorimin dhe keqpërdorimin e pasurisë.

Objektivi i veprimtarisë së Inspektoratit Qëndror është:

- Bashkërendon dhe mbështet veprimtarinë e inspektorateve shtetërore e të inspektorateve vendore;
- Jep mendim këshillimor për programet e inspektimit, të hartuara nga inspektoratet shtetërore;
- Miraton rregulla të përgjithshme, bazë, për metodologjinë e vlerësimit të riskut, programimin e inspektimeve, dokumentimin e veprimtarisë së inspektimit, si dhe raportimin e veprimtarisë së inspektorateve;
- Miraton rregulla të përgjithshme për treguesit e përgjithshëm të efektivitetit dhe të cilësisë së veprimtarisë së inspektimit, si dhe kriteret e vlerësimit të tyre;
- Jep mendime për çdo nismë ligjore dhe nënligjore në fushën e inspektimit;
- Mbikëqyr zbatimin e këtij ligji e të ligjit të posaçëm nga inspektorët shtetërorë, për programimin, autorizimin dhe kryerjen e procedimit të inspektimit, dhe ka të drejtë të propozojë marrjen e masave disiplinore ndaj inspektorëve dhe Kryeinspektorit Shtetëror, në rast të konstatimit të shkeljeve prej këtyre të fundit;
- Përgatit raportin vjetor të përgjithshëm të inspektimeve dhe ia paraqet për njohje Këshillit të Ministrave;
- Bashkërendon veprimtarinë e trajnimit e të kualifikimit të inspektorëve;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “INSPEKTORATIN QËNDROR”

- Miraton kërkesat specifike për arsimimin e inspektorëve në inspektoratet shtetërore dhe vendore;
- Kryen testimin fillestar dhe periodik të inspektorëve;
- Krijon dhe mban një portal unik të inspektimit, që shërben për programimin dhe bashkërendimin e inspektimeve, shkëmbimin e të dhënave ndërmjet inspektorateve të ndryshme, si dhe për informimin e publikut;
- Mban listën e përditësuar të inspektorëve në detyrë për çdo inspektorat shtetëror dhe vendor dhe e publikon atë në faqen zyrtare të internetit.

Për periudhën objekt auditimi 01.01.2018-31.08.2019, rezultoi se:

Në referencë të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, pika 4, germa “b” i cili citon se “Nëpunësi autorizues i të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë përgjegjësi kryesore hartimin e objektivave dhe zbatimin e planeve strategjike dhe vjetore, në përputhje me objektivat e miratuara nga titullari i njësisë”, nga auditimi u konstatua se ky institucion ka hartuar planin strategjik 2017-2019, i cili përmban objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit.

-Krijimi i **Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS)**, në referencë të ligjit nr. 10296 date 07.08.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, GMS luan një rol kyç për sa i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemin e saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljen etike dhe se ky grup përbëhet nga titullari i njësisë publike, zëvendës titullarët, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues dhe të gjithë menaxherët e tjerë të nivelit të lartë. Nga auditimi u konstatua se, në Inspektoratin Qëndror me Urdhrin nr.93, datë 18.12.2017 është përcaktuar “ Ngritja e Grupit të Menaxhimit Strategjik Për Menaxhimin dhe Kontrollit për Inspektoratit Qëndror”, me përbërje : T. K, E.B, A.F, D.B dhe D. D.

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Inspektoratit Qëndror për periudhën **01.01.2018-31.08.2019**, me shkresën nr.39/1, datë 27.02.2019, si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët e kontrollit të brendshëm në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

1. Mjedisi i kontrollit.

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin, ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Mjedisi i kontrollit përmban: Integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; politikat menaxheriale dhe stilin e punës; strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

a. Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike.

Në referencë të ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, si dhe ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, nevojitet që punonjësit të respektojnë normat etike dhe profesionale të bashkëpunimit e të ndihmës së ndërsjellët, mbështetur në krijimin e një Kodi të Brendshëm Etik. Nga auditimi u konstatua se, Institucioni ka hartuar një kod etike “Kodi i Etikës për Punonjësit e Inspektorateve Shtetërore në Republikën e Shqipërisë”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “INSPEKTORATIN QËNDROR”

b. Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Inspektorati Qëndror funksionon në bazë të strukturës së miratuar me urdhrin e Kryeministrit Nr.24, datë 03.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit Qëndror”. Inspektorati Qëndror ka hartuar Rregulloren e Brendshme të Inspektoratit Qëndror si dhe Rregulloren me urdhrin nr.25, datë 10.08.2018 “Për përcaktimin e Procedurës së Inspektiveve, si një Proces i Rregullt Administrativ”. Këto rregullore bazohen në kuadrin ligjor ekzistues. Në Rregulloren e brendshme të IQ, janë përcaktuar struktura organizative e IQ-së funksionet dhe detyrat e të gjithë punonjësve, si dhe marrëdhëniet midis tyre, kanalet dhe mënyrat e komunikimit. Detyrat funksionale të çdo punonjësi janë përcaktuar në përshkrimet e punës së gjithsecilit.

c. Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit. Në Përputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 15 “Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave”, si dhe Kapitulli III “Delegimi i detyrave”, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kemi konstatuar se janë pjesë e rregullores e brendshme të miratuara nga titullari, delegimi i detyrave dhe mënyra e dokumentimit të tyre.

d. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore. Nga auditimi u konstatua se, për periudhën **01.01.2018-31.08.2019**, janë kryer vlerësimet e punonjësve për vitin 2018 dhe gjatëmujorin e parë të vitit 2019.

Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve gjatë viteve të objekt auditimit, nga auditimi u konstatua se, *ky institucion ka programe specifike për trajnimin e punonjësve të administratës për vitin 2018 dhe periudhën prill – dhjetor 2019.*

2. Menaxhimi i riskut.

Nga auditimi u konstatua se, ky institucion ka miratuar regjistrin e riskut, pra ka bërë vlerësimin dhe kontrollin e risqeve për vitet 2018 dhe 2019, të cilat venë në rrezik arritjen e objektivave ku drejtuesit janë të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kanë në menaxhimin e riskut. Në këtë regjistër risku janë përshkruar në mënyrë të detajuar : përshkrimi i riskut, përshkrimi i impaktit , veprimet/detyrat e përfunduara , veprimet/detyrat e planifikuara dhe masat parandaluese

3. Aktivitetet e kontrollit.

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave. Proceset kryesore të punës janë të shkruara në rregulloren e brendshme dhe në bazë të strukturës së miratuar ekziston dhe ndarja e detyrave. Nepunësi autorizues në bazë të ligjit për buxhetin merr përsipër angazhimet për realizimin e programit buxhetor. Referuar ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar neni 16, si dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. III “Procesi i implementimit të Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit”, pika 3.2 “Cikli i MFK-se”, Hapi 5 “Gjurmët e auditimit”, “Mbi gjurmën e auditimit”, nga ana e Institutit janë hartuar gjurmët e auditimit.

Për të plotësuar nevojën për informacion, njësia ka instaluar sistemin e IT-së “e-Inspektimi”. IQ ka miratuar Manualin e Mbikëqyrjes së veprimtarisë së inspektimit pranë Inspektorateve Shtetërore/Vendore dhe trupave të tjera inspektuese, i cili bën të mundur unifikimin dhe lehtësimin e procesit mbikëqyrës ndaj inspektorateve të kontrolluara nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Inspektiveve, Udhëheqjes Metodologjike dhe Koordinimit (DMIUMK). Në manual përshkruan hap pas hapi, parimet që do të ndiqen, operacionet e punës, metodologjinë e përdorur duke nënvizuar rëndësinë e secilës prej tyre. DMIUMK, ka hartuar formatin standard të Deklaratës së objektivitetit, kompetencës dhe paañsisë, si një nga dokumentet e saj të



rëndësishme për të garantuar zhvillimin e mbikëqyrjeve të pavarura, objektive dhe me nivel të lartë profesional.

4. Informim komunikimi.

Nga auditimi u konstatua se, përgjithësisht komunikimi me titullarin dhe nëpunësit e tjerë është bërë në formën dhe kohën e duhur, për ti ndihmuar ata në përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësiave. Titullari është informuar nga drejtuesit me anë të mbledhjeve, nëpërmjet relacioneve dhe raporteve rreth këtyre mbledhjeve. *Spektori i Financës nuk ka raportuar tek nëpunësi autorizues me anë të situacioneve buxhetore mujore dhe vjetore të krahasuar me planin, duke mos hartuar raporte monitorimi mujore, apo tremujore.* Punonjësit brenda institucionit vijnë të komunikojnë me postë elektronike dhe në mënyrë verbale ndërsa, jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme, pa përjashtuar komunikimin elektronik dhe atë telefonik. IQ ka faqen e tij zyrtare dhe nëpërmjet këtij ëbsite të gjithë të interesuarit mund të informohen rreth punës së përditshme të Inspektoratit Qëndror.

5. Monitorimi.

Nga auditimi i të gjitha fushave të veprimtarisë së këtij institucioni rezultoi se, *nuk janë hartuar raportet e monitorimit të buxhetit dhe raportet e monitorimit vjetor të tij, sipas ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, në nenin 65 “Monitorimi”, në të cilin citohet: “Nëpunësit autorizues të njësiave të qeverisjes qendrore, i paraqesin sa herë që kërkohet, por jo më pak se katër herë në vit, nëpunësit të parë autorizues, raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit, për performancën financiare, produktet dhe objektivat e realizuar për çdo projekt të përcaktuar në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të projektit buxhetor afatmesëm”.* Trajtuar më hollësisht në pikën 1 të programit të auditimit.

3. TË TJERA QË REZULTOJNË GJATË AUDITIMIT

Prokurimet e fondeve publike

a. Zbatimi i legjislacionit për realizimin e procedurave të prokurimit publik.

Gjatë auditimit, mbi procedurat e prokurimeve të realizuara në Inspektoratin Qëndror, përgjatë viteve të audituara 2018 deri në 31.08.2019, në bazë të Programit të Auditimit, grupi i audituesve të KLSH-së, u fokusua në zbatimin e bazës ligjore dhe nënligjore ligji nr. 9646 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, VKM nr. 918 datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”, Udhëzim e APP-së nr. 2 datë 27.01.2015 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të prokurimit publik”, Udhëzimin e APP-së nr. 3 datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël” dhe çdo akti juridike që është në fuqi në lidhje mbi prokurimet publike të financuara nga Buxheti i Shtetit.

Në bazë të regjistrave të parashikimit dhe ato të realizimit për vitin 2018 dhe 8 mujorin e vitit 2019, Grupi auditimit, konstatoi se pranë Inspektoratit Qëndror, janë kryer procedura tenderuese kryesisht “Prokurime me Vlerë të Vogël”, dhe procedura “Tender i hapur”, të cilat janë realizuar nga AKSHI, për rrjedhojë vendosi auditimin e disa prej procedurave, duke i përzgjedhur me metoda me zgjedhje rastësore, metoda e gjurmimit të dokumentacionit si dhe çdo paqartësi është diskutuar me personat përgjegjës për procesin e prokurimit të audituar. Përqendrimi i grupit të auditimit është mbështetur në pikat e renditura të audituara si më poshtë:

- Hartimin dhe njoftimin e regjistrit të prokurimit publik;
- Llogaritjen e fondit limit dhe procedurat e shpalljes së prokurimit;
- Hartimi i kërkesave për kualifikim, miratimi i dokumenteve standarde të tenderit;
- Paraqitja dhe shqyrtimi i ofertave;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “INSPEKTORATIN QËNDROR”

- Vlerësimi i ofertave dhe klasifikimi i ofertuesve, verifikimi në sistemin prokurimit elektronik (SPE);
- Menaxhimi i procesit të ankimit, pjesëmarrësit në proces;
- Njoftimi, hartimi dhe nënshkrimi i kontratës me operatorin fitues dhe zbatimi i saj.
- Zbatimi dhe monitorimi i kontratës.

Kështu sa më sipër, për vitin 2018, nga auditimi u konstatua se, nga fondi limit total prej 65.954.147 lekë pa tvsh, i vënë në dispozicion nga të ardhurat e Institucionit janë zhvilluar 17 procedura “Prokurim me vlerë të vogël”, 2 procedura “Tender i hapur” të cilat janë zhvilluar nga AKSHI, 3 procedura kërkesë për propozim dhe 6 procedura blerje nën 10.000 lekë.

Për periudhën 8 mujorin e vitit 2019, nga auditimi u konstatua se nga fondi limit total prej 98,591,000 lekë pa TVSH, i vënë në dispozicion nga ardhurat e Institucionit për vitin 2019 janë zhvilluar 5 procedura me vlerë të vogël, të cilat janë përlogaritur në vlerë kontrate të realizuara prej 1.296.697 lekë me TVSH.

Nga auditimi i tyre, u konstatua se mme Urdhrin nr.1, datë 05.01.2018 është ngritur Komisioni i Njësisë së Prokurimit dhe të Prokurimit të Blerjeve të Vogla me përbërje: E.B, A.P dhe D.B. Për vitin 2019 me Urdhrin nr.1, datë 05.01.2019 është ngritur Komisioni i Njësisë së Prokurimit dhe të Prokurimit të Blerjeve të Vogla me përbërje: A.P, G.Z dhe E.L.

U konstatua se procedurat janë realizuar në përputhje me bazën ligjore dhe nënligjore. Në të gjitha procedurat e audituara duke i verifikuar si në dosjen fizike dhe në sistemin e prokurimit elektronik, u evidentua se, ka fituar operatori ekonomik me çmimin më të ulët dhe nuk ka pasur ankesa, në lidhje mbi vendosjen e kriterëve specifike kualifikuese nga ana e Njësisë së Prokurimit, në drejtimin e shqyrtimit të ofertave si dhe në klasifikimin e ofertuesve.

Problematikat e konstatuara në procedurat prokuruese të audituara për vitin 2018 dhe periudha deri në 31.08.2019, në kundërshtim me ligjin nr. 9646 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe çdo akti normativ nënligjor të fushës, janë si më poshtë:

-Për të gjitha procedurat e audituara me zgjedhje nuk janë hartuar procesverbale për shpalljen e fituesit në rastet kur ofertuesi i renditur në vend të parë tërhiqet nga oferta e tij ose nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor sipas VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 40, pika 5, dhe Udhëzimit nr.03, Datë 8.01.2018 “Mbi Përdorimin E Procedurës Së Prokurimit Me Vlerë Të Vogël Dhe Zhvillimin E Saj Me Mjete Elektronike”, pika 17.

- Dosjet e procedurave të prokurimeve nuk janë të inventarizuara dhe të arkivuara, në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat.

- Për të gjithë procedurat e audituara konstatohet se nga autoriteti kontraktor nuk është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim dhe nuk ka procesverbale të marrjes në dorëzim të mallit/shërbimit në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në njësitë e Sektorit Publik” pika 42-50.

Situata	-Nga auditimi u konstatua se për të gjithë procedurat e audituara konstatohet se nga autoriteti kontraktor nuk është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim dhe nuk ka procesverbale të marrjes në dorëzim të mallit/ shërbimit .
Kriteri	-Udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në njësitë e Sektorit Publik” pika 42-50.
Ndikimi/Efekti:	Nga mos ngritja e komisionit të marrjes në dorëzim nuk dihet mallrat/shërbimet janë në përputhje me të dhënat e verifikuara, me faturën dhe kushtet e kontratës.
Shkaku:	Mos ngritja e komisioneve për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “INSPEKTORATIN QËNDROR”

Rëndësia:

I Mesëm

Në përfundim për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë

1. Gjetje nga auditimi: Inspektorati Qendror nuk ka përgatitur raportet e monitorimit 4, 8, 12 mujore me relacione shpjeguese të realizimit të tregusve me planin, si dhe masat korrigjuese që duhet të ndërmerren për përmirësimin e situatës. Veprime në mospërputhje me pikën 3.3/33 kapitulli III, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 8,9,10 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim: Inspektorati Qendror të marrë masa në vazhdimësi, që të përpilojë raportet e monitorimit 4, 8, 12 mujore, ku të relatohet në lidhje me realizimin e tregusve në raport me parashikimin, me qëllim menaxhimin sa më efektiv të fondeve buxhetore, si dhe ndërmarrjen në kohë të veprimeve korrigjuese duke ndryshuar alokimin e burimeve, si dhe duke evidentuar impaktin e mundshëm në performancën e objektivave të lidhura me to.

Në raportet e monitorimit për 8- mujor të jepet informacionet shtesë për parashikimin e realizimeve të pritshëm deri në fund të vitit si për produktet edhe për shpenzimet, për të evidentuar nëse ky parashikim është më i lartë apo më i ulët se plani fillestar i parashikuar. Gjithashtu IQ të marra masat në vazhdimësi, që Raporti i Monitorimit të publikohen në faqen zyrtare të tyre në ëeb.

Në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga kontrolli i zërave të pasqyrës së ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto dhe të pasqyrës së pozicionit financiar rubrika C u konstatua se, llogaria 105 “Teprica e Granteve kapitale të Brendshme” dhe llogaria 106 “Teprica e Granteve kapitale të Huaja” rezultojnë me tepricë në fund të periudhave ushtrimore, çka do të thotë se këto grante janë burim për investimet në proces për institucionin (të papërfunduara ose të pamarra në dorëzim). Por nga analiza e zërave të pasqyrës nuk rezulton që institucioni të ketë investimet në proces (të papërfunduara ose të pamarra në dorëzim). IQ-rë i ka marrë në dorëzim të gjitha investimet e realizuara në vite dhe i ka kapitalizuar në llogarinë 21. Pra rezulton se institucioni në fund të periudhës kontabël nuk ka bërë veprimin e mbylljes duke debituar 105 “Teprica e granteve kapitale të brendshme” ose 106 “Teprica e granteve kapitale të huaja”; dhe kredituar llogarinë 1011 “Shtesa në fondet bazë”. Veprime në mospërputhje me pikën 1.1 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i klasës 1” të udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësinë e qeverisjes së përgjithshme”.
(Trajtuar më hollësisht në faqet 17, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse së IQ të marri masat për sistemimin e llogarisë 105 “Teprica e Granteve kapitale të Brendshme” për shumën (147,553,600) lekë dhe llogarisë 106 “Teprica e Granteve kapitale të Huaja” për shumën 558,200 lekë duke debituar tepricën e tyre dhe kredituar llogarinë 101 “Fonde Bazë”, veprime të cilat do të reflektohen në pasqyrat financiare të vitit 2019.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Llogaria 230 “Per aktive afatgjata jomateriale” në vlerën 27,220,800 lekë dhe llogaria 231 “Per aktive afatgjata materiale” në vlerën 48,996,750 lekë kanë të bëjnë me aktive afatgjata, para se të vihen në shfrytëzim, pra para se këto aktive të jenë funksionale ato



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “INSPEKTORATIN QËNDROR”

detyrimisht duhet të gjenden në proces, në formën e shpenzimeve që grupohen në llogarinë 23 “Investime”. Nga analiza e zërave të investimit dhe kapitalizimit të tyre u konstatua se këto investime nuk janë në proces janë investime të përfituara dhe të marra në dorëzim nga institucioni, të cilat kanë të bëjnë me shërbimin e mirëmbajtjes së sistemit të Inspektoratit, në bazë të kontratës 4-vjecare me nr. 130/1, datë 01.01.2014 deri me datën 31.12.2017 dhe amendimit nr. 702, datë 28.12.2017 për shtesë kontrate.

Institucioni në fund të periudhës ushtrimore të vitit 2018 duhet ti kapitalizonte në grupet 20 e 21 të aktiveve të përfunduara dhe vlera totale prej 76,217,550 lekë duhet të kalonte e kapitalizuar bashkë me sistemin të AKSHI në mbështetje të pikave 18-20 të VKM-së nr .673, datë 22.11.2017 “Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, e dorëzuar me Akt-dorëzimin nr.440\2, datë 09.10.2018.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse së IQ të marri masat për sistemimin e llogarisë 230 “Per aktive afatgjata jomateriale” në vlerën 27,220,800 lekë dhe llogaria 231 “Per aktive afatgjata materiale” në vlerën 48,996,750 lekë duke i kapitalizuar në llogarinë 20-21 dhe në fund të vitit 2019 këto shuma të kalojnë për llogari të AKSHI-it, veprime të cilat do të reflektohen në pasqyrat financiare të vitit 2019.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Në fund të procesit të inventarizimit u konstatua se komisioni nuk ka përpiluar një raport në lidhje me inventarizimin fizik të aktiveve, ku të japte komentet në lidhje me gjendjen fizike aktuale të aktiveve (nëse janë apo jo në përdorim), si dhe për kushtet e ruajtjes së tyre dhe së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzonte për veprime të mëtejshme titullarit të institucionit, veprime në kundërshtim me pikën 85/c të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Nga auditimi u konstatua se para fillimit të inventarit nuk ishte vendosur numri rendor i fletë hyrjes dhe i fletë daljes nëpërmjet një procesverbal, i cili mbahet midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit, veprim në kundërshtim me pikën 83 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011.

- Për vitet objekt auditimi u konstatua se komisioni i inventarizimit nuk ka nxjerrë një vlerë totale dhe listë të detajuar, se sa ka gjendje fizike institucioni, për pajisje informatike, për pajisje zyre të ndarë në artikuj, si dhe mjete transporti në dispozicion etj., sipas formatit të regjistrit të aktiveve, i cili hartohet në vartësi të llojit të tyre, si dhe grupit përkatës brenda llojit dhe më pas të bëhej krahasimin gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të regjistruara në kontabilitet, për të vërtetuar nëse ekzistojnë apo jo diferenca, veprime në kundërshtim me pikat 30, 73, 74, 81 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 23-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Komisioni i inventarizimi, i cili ngrihet çdo vit nga Titullari i Institucionit të IQ-rë të marrë masa, që në raportin që i drejtohet titullarit në fund të procesit të inventarizimit, të bëjë një ndarje të aktiveve gjendje që disponon institucioni, sipas zërave duke bashkëngjitur listën e tyre në relacionin, me qëllim verifikimin reale të gjendjes së tyre, si dhe verifikimin më lehtësisht të diferencave të gjendjes së tyre fizike me të dhënat e regjistruara në kontabilitet sipas zërave. Në momentin që komisioni i ngritur nuk arrin të bëjë inventarizimin e zërave të caktuar të kërkojë nga titullari, për të ngritur grup pune me ekspertë të fushës, për aktivet që nuk mund ti inventarizojnë.

Në vazhdimësi

5. Gjetje: -Nga auditimi i procedurave të prokurimit nuk janë hartuar procesverbale për shpalljen e fituesit në rastet kur ofertuesi i renditur në vend të parë tërhiqet nga oferta e tij ose nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor sipas VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “INSPEKTORATIN QËNDROR”

të prokurimit publik” neni 40, pika 5, dhe Udhëzimit nr.03, Datë 8.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me Vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 17.

- Dosjet e procedurave të prokurimeve nuk janë të inventarizuara dhe të arkivuara, në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat.

- Nga auditimi i procedurave të prokurimit u konstatua se mungon ngritja dhe komisionit për marrjen në dorëzim dhe vlerësimin e mallrave dhe relacioni për të verifikuar nëse specifikat e mallit/shërbimit të marrë në dorëzim janë apo janë përputhje me kriteret e parashikuara, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në njësitë e Sektorit Publik” pika 42-50.

Më hollësisht trajtuar në faqe nr.27-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

5.Rekomandimi: Njësia e Prokurimit të marrë masa për çdo procedurë të hartojë procesverbale për shpalljen e fituesit në rastet kur ofertuesi i renditur në vend të parë tërhiqet nga oferta e tij ose nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor.

-Të kryhet inventarizimi dhe arkivimi i dosjeve nga Njësia e Prokurimit për çdo procedurë prokurimi.

-Të merren masa, që për çdo marrje në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, të ngrihet komisioni i marrjes në dorëzim, i cili duhet të përpilojë procesverbalin nëse mallrat/shërbimet janë në përputhje me të dhënat e verifikuara, me faturën dhe kushtet e kontratës, pastaj të bëhet fletë-hyrja në magazinë dhe regjistrimi i tyre në kontabilitet.

Në vazhdimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT



Aneksi I:

Qasja dhe metodologjia e auditimit.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal nivelin të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë pragun e materialitetit prej 2%, duke rritur gamën e gabimeve për tu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti dhe kryqëzimin e tyre me të dhënat e gjeneruara nga databaza e sistemit të Thesarit, në Ministrinë e Financave, si edhe rakordimi në situacionet e Thesarit. Konkretisht, (A) mbi transaksionet u aplikuan:

Teknikat e kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit mbi vlerësimin e riskut.

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*)

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) konstatoi se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.

Subjekti që auditohet nuk ka të konfirmuara (*Rakorduar*) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepcave ose regjistrimeve të tjera.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka: *mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.*

Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik; dhe
- Pështetja specifike që ky zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit

Për të përzgjedhur minimumin e çështjeve për auditimi, mbi këta zëra shpenzimesh, u aplikuan format e përlllogaritjes si më poshtë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “INSPEKTORATIN QËNDROR”

Emërtimi i Shpenzimeve 2018	Vlera e Popullatës	Faktori i Riskut (0.7-2-3)	Çështje për tu shqyrtuar
Paga (600)	21,329,239	0.7	4
Sigurime Shoqërore (601)	3,383,493	0.7	4
Mallra e Shërbime (602)	12,689,094	2	6
Transferta familjare 606	30,000	0.7	0
Investime të brenda. (230-231)	24,015,484	2	2
Total	61,447,310		
<i>Materialiteti në %</i>	2%		
Materialiteti në vlerë	1,228,946		
<i>Kalkulimi i precizionit</i>			
Materialiteti	1,228,946		
<i>Gabimi i lejuar (10% - 20%)</i>	122,895		
Nëntotali	1,106,052		
<i>Precizioni i planifikuar (80-90%)</i>	90%		
Vlera e precizionit	995,446		

Emërtimi i Shpenzimeve 31.08.2019	Vlera e Popullatës	Faktori i Riskut (0.7-2-3)	Çështje për tu shqyrtuar
Paga (600)	13,242,957	0.7	1
Sigurime Shoqërore (601)	2,124,208	0.7	1
Mallra e Shërbime (602)	4,186,228	2	2
Transferta familjare 606	0	0.7	0
Investime të brenda. (230-231)	9,542,400	2	1
Total	29,095,793		
<i>Materialiteti në %</i>	2%		
Materialiteti në vlerë	581,916		
<i>Kalkulimi i precizionit</i>			
Materialiteti	581,916		
<i>Gabimi i lejuar (10% - 20%)</i>	58,192		
Nëntotali	523,724		
<i>Precizioni i planifikuar (80-90%)</i>	90%		
Vlera e precizionit	471,352		

Nisur nga rezultatet sa më sipër, për analizën e pasqyrave financiare të vitit 2018 dhe transaksioneve të realizuara nga subjekti deri me datën 31.08.2019, grupi i auditimit mori në shqyrtim disa çështje për të verifikuar saktësinë, ndodhjen, ligjshmërinë, dhe kontabilizimin, mbi llogarinë 600 dhe 601. Gjithashtu u shqyrtuan çështje për llogarinë 231 për të verifikuar plotësinë, ndodhjen, matjen, rregullshmërinë dhe zbatueshmërinë; si dhe çështje për llogarinë 602. Mbi verifikimin dhe rakordimin e gjendjeve të llogarive në fund të periudhës, grupi i auditimit analizoi dhe verifikoi ekzistencën, plotësinë, vlerësimin dhe alokimin e tyre.

Ndërsa sa i takon pohimeve rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese më së shumti u mor në konsideratë kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi i zërave në këto relacione.

Përzgjedhjen e urdhër shpenzime dhe prokurimeve është bërë duke parë brenda kontekstit të natyrës specifike të shpenzimeve, të cilat mbartin risk, duke marrë në konsideratë dhe faktorët si:

- vlerat e pagesës

- ngjarje apo transaksione të rëndësishme si kontrata të rëndësishme prokurimi, kontrata për investime afatgjatë, të cilat mund të jenë shkas për ndonjë risk më të lartë.

- afati kohor që nga data e urdhër shpenzimit me datën e faturës së lëshuar për kryerjen e shërbimit, për të analizuar arsyen e këtyre vonesave në ekzekutim, duke kaluar afatin 30 ditore të parashikuar në legjislacion.



- ekzekutimi i pagesave në lidhje me vendimet e formës së prerë duke marrë parasysh afatin e zgjatjes së pagesës nga vendimi deri në ekzekutimin e pagesës nga institucioni.

Për vitin 2018 deri me 31.08.2019 **grupi i auditimit mbuloi me auditim shpenzimet operative (llogaria 602)** blerjet e vogla për shërbime e mallra të realizuara nga institucioni gjatë vitit ushtrimor 2018 dhe periudhës 01.01.2019-31.08.2019.

Mbulimi me auditim i shpenzimeve në lidhje me investimet (230-231), duke pasur parasysh vlerën e precizionit, për vitin 2018 dhe periudhën 31.08.2019 sqarojme se janë investime në lidhje me sistemin e Inspektoratit i cili menaxhohet nga AKSHI.

Aneksi II:

Llojet e opinionëve të aplikuara nga KLSH.

Baza për Opinionin

a. Manuali i auditimit financiar të KLSH.

Audituesi duhet të shprehë një **opinion të pamodifikuar** mbi ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve kur audituesi konkludon se transaksionet përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator që zbatohet për transaksione të tilla.

Një **opinion i pakualifikuar (pa rezervë)** jepet kur audituesi është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale se:

- a) pasqyrat financiare janë përparë duke përdorur baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika të cilat janë aplikuar në vazhdimësi;
- b) pasqyrat janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe me rregulloret përkatëse;
- c) situata e paraqitur nga pasqyrat financiare është në përputhje me njohuritë e audituesit mbi njësine publike të audituar; dhe
- d) janë paraqitur saktë të gjitha çështjet materiale që lidhen me pasqyrat financiare.

Opinionin me rezerve. Opinionin me rezerve do të jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt për një ose më shumë çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale, por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave. Formulimi i opinionit zakonisht tregon një rezultat të kënaqshëm të subjektit të auditimit në një deklaratë të qartë dhe koncize të çështjeve të mospajtimit ose të pasigurisë, duke çuar në opinionin me rezerve. Nëse efekti financiar i paqartësisë apo i mosmarrëveshjes është i përcaktuar si shumë nga audituesi, ndonëse nuk është gjithmonë e praktikuar ose e përshtatshme, atëherë kjo do të shërbente si ndihmë për përdoruesit e pasqyrave.

Opinionin i kualifikuar. Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar:

1. kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose
2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.

Opinionin negativ (kundërshtues). Opinionin negativ (kundërshtues) do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur të krijojë një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, si pasojë e mospërputhjes aq shumë vendimtare sa të përmbys situatën e paraqitur në atë masë që një opinion me rezerve në aspekte të caktuara nuk do të ishte i përshtatshëm. Formulimi i këtij opinionit qartëson faktin se pasqyrat financiare nuk janë deklaruar saktësisht duke specifikuar në mënyrë të thjeshtë dhe koncize të gjitha rastet e mospërputhjes. Gjithashtu, aty ku është me vend dhe është e mundur, do të ishte e dobishme sikur ndikimi financiar mbi pasqyrat financiare të përcaktohej në shumë.

Refuzim i opinionit. Refuzimi i opinionit do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur që të mbërrijë në një opinion për sa i përket pasqyrave financiare të marra në tërësi, si pasojë e pasigurisë apo e kufizimit të fushëveprimit aq shumë thelbësor, në mënyrë që një opinion me rezerve në disa aspekte të caktuara të mos jetë i përshtatshëm. Formulimi i refuzimit të opinionit



qartëson faktin se është e pamundur të jepet një opinion duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha rastet e paqartësisë.

Aneksi III:

Auditimi i detyrimeve (Të tjera operacione me shtetin).

(Bazuar në klasifikimin ekonomik të llogarive të planit kontabël publik, Ministria e Financave).

Llogarite e marrëdhënieve me shtetin (42 e 43).

Nëmarrëdhëniet e institucioneve me shtetin përdoren dy llogari specifike dhe karakteristike për sektorin publik buxhetor.

- llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin debitor”

- llogaria 4341 “Të tjera operacione me shtetin kreditor”

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin debitor” është një llogari që në pasqyrat financiare të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore por ende të papaguara. Raste të tilla mund të jenë këto (por jo vetëm këto) si; pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore, apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat, që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm.

Nëse veprimi kontabël:

- a. Është bërë gjatë konstatimit të shpenzimit veprimi;
 - debi llogarite respektive të klasës 6 “shpenzime korrente”,
 - kredi llogarite e detyrimeve afat shkurtër për konstatimin e detyrimit (42,43,40, e tjera).
- b. Në fund të periudhës ushtrimore është bërë veprimi;
 - debi llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin debitor”
 - kredi llogari 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”
- c. Me akordimin e fondeve vitin e ardhshëm dhe ekzekutimin e pagesës është bërë veprimi;
 - debi llogaritë përkatëse të detyrimeve (klasa 4)
 - kredi llogaria 520 “Disponibilitete në thesar”.
- d. Paralel me veprimin e mësipërm nëse është artikulluar veprimi tjetër;
 - debi llogaria 476 “Të ardhura të përcaktuara për tu përdorur”
 - kredi llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin debitor”;

Llogaria 4341 “Të tjera operacione me shtetin kreditor”, është një llogari që në pasqyrat financiare të sektorit publik paraqitet në pasiv në rubrikën e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuar e të pa arkëtuara nga vitet e mëparshme.

Nëse veprimi kontabël;

- a. Është bërë konkretisht kur më parë ka ndodhur situata për konstatimin e një të ardhure (pavarësisht raportit të pjesëmarrjes buxhet apo institucion);
 - debi llogaria 411/468, “klientë e llogari të ngjashme” apo “debitorë të ndryshëm”,
 - kredi llogarite respektive të klasës 7, të ardhura të konstatuar.
- b. Kur e ardhura në fund të periudhës ushtrimore nuk është arkëtuar dhe për pjesën që i takon buxhetit duhet të konstatohet detyrimi;
 - debi llogaria 8424 “Transferim për debitorë të konstatuar të ngjashëm”,
 - kredi llogaria 4341 “Të tjera operacione me shtetin kreditor”,
- c. Në momentin kur arkëtohet e ardhura është kryer veprimi;
 - debi llogaria 520 “Disponibilitete në thesar”;
 - kredi llogaria 411/468, “klientë e llogari të ngjashme” apo “debitorë të ndryshëm”,
- d. Me qenë se e drejta u arkëtua dhe llogaria 520 është llogari e thesarit nëse në fund të periudhave përkatëse është bërë veprimi përkatës;
 - debi llogaria 4341 “Të tjera operacione me shtetin kreditor”,



- kredi llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” (për mbylljen e kësaj pjese).

Aneksi IV:

Auditimi i detyrimeve

(Bazuar në klasifikimin ekonomik të llogarive të planit kontabël publik, Ministria e Financave).

Llogaria 45 “Marrëdhënie me institucionet brenda dhe jashtë sistemit”.

Ky grup llogarish përfaqëson specifikat që shoqërojnë marrëdhëniet e institucioneve me njëra tjetrën dhe me të tjerë të tretë për xhirimet materiale në natyrë.

Nga pikëpamja e kontabilitetit institucionet e lidhura auditohen nëse përgjithësisht kanë përdorur skemën si me poshtë;

a. Institucioni dhënës i cili ka kryer blerjet mbi bazën e fondeve të akorduara sipas skemës së zakonshme të buxhetimit, përveç veprimeve që lidhen me blerjen e operacionet e tjera buxhetore, nëse i ka bërë hyrje materialet e blera.

- Debi llogaritë e klasës 3 në kredi të llogarisë 63 “Ndryshim i gjendjeve të inventarit”.

b. Institucioni dhënës për daljet pa pagesë që u bën njësisive vartëse apo të tretëve nëse;
- Krediton llogaritë përkatëse të klasës 3 me kundër parti debitin e llogarive të grupit 45 “Marrëdhënie me institucionet brenda dhe jashtë sistemit”.

c. Institucioni dhënës nëse ka mbyllur llogarinë 45 pas marrjes së konfirmimit nga institucioni përfitues dhe ka;

- debituar llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në kredi të grupit 45 “Marrëdhënie me institucionet brenda dhe jashtë sistemit”.

d. Institucioni marrës i këtyre vlerave nëse i ka bërë hyrje ato duhet të;

- debitojë llogarite përkatëse të klasës 3 me kundër parti kreditimin e llogarisë së grupit 45 “Marrëdhënie me institucionet brenda dhe jashtë sistemit”.

e. Institucioni marrës nëse e ka mbyllur llogarinë 45 “marrëdhënie me institucionet brenda dhe jashtë sistemit” me dërgimin e konfirmimit në institucionin dhënës dhe të debitojë këtë llogari në kredi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

f. Llogaria 45 “Marrëdhënie me institucionet brenda dhe jashtë sistemit” në fund të periudhës ushtrimor duhet të rakordohet dhe, si rregull, duhet të jetë e mbyllur.

Llogaria 466 “Kreditorë për Mjete në ruajtje”.

Është llogari specifike në sektorin publik.

Në kredi të saj regjistrohen të hyrat (të ardhurat) që vijnë në llogarinë e thesarit të institucioneve të cilat në një periudhë tjetër do t’u kthehen nga kjo llogari të tretëve.

Të tilla mund të jenë:

- mjetet e xhiruara për llogari të zyrës së përmbarimit,
- paradhëniet e paguara nga të tretet për pjesëmarrje në ankande,
- garancitë bankare të ndryshme,
- të hyra për llogari të komisionit të kthimit e kompensimit të pronave,
- derdhjet e ndryshme të bëra gabim dhe që duhet të rikthehen,
- depozitime të kontributeve në avancë apo ndonjë depozitim tjetër,
- rimbursimi i tvsh nga llogaria e tatimeve,
- etj.

Llogaria 476 “Të ardhura të përcaktuara për tu përdorur”, përdoret si llogari kalkulative gjatë vitit ushtrimor.

Veprimet e mundshme në kontabilitet me këtë llogari janë;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “INSPEKTORATIN QËNDROR”

- Debi llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” në kredi të llogarisë 476, për akordimin e fondeve buxhetore.
- Debi llogaria 476 (ose kredi me stornim) në kredi të llogarisë 520 (ose debi me stornim) për fondet buxhetore të pa përdorura në fund të periudhës ushtrimore dhe që nuk trashëgohen për vitin e ardhshëm.
- Debi llogaria 476 në kredi të llogarisë 105, “Grante të brendshme kapitale” apo në kredi të llogarisë 720 “Grante korrente të përgjithshme” lidhur me përdorimet e këtyre fondeve respektivisht për investime e për shpenzime funksionimi.
- Debi llogaria 476 në kredi të llogarisë 4342, paralel me pagesën e bërë për shlyerje detyrimesh të vitit të mëparshëm me fondet e akorduara të vitit ushtrimor.

Llogaria 481 “Shpenzime për tu shpërndarë në disa ushtrime”, karakteristike kryesisht për institucionet e vetëqeverisjes vendore. Është llogari rregulluese ku përfshihen shpenzimet e kryera për riparimet e mëdha, shpenzimet për punime parapërgatitore të një lloji veprimtarie, shpenzime të kryera gjate vitit ushtrimor (që nuk përfshihen në aktivet e qëndrueshme dhe nuk mund të rëndohen tërësisht në rezultatin e ushtrimit). Këto shpenzime shpërndahen (amortizohen) në vitet e ardhshme.

Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”. Kjo llogari përfshihet në grupin e llogarive rregulluese. Përfaqësojnë shpenzime për blerje ose shërbime, realizimi faktik i te cilave ndodh në një ushtrim të ardhshëm (shpenzime te parapaguara), si p.sh. qira të paguara në avancë, prime të sigurimeve për rreziqe të paguara avancë, e tjera.

Llogaria 475 “Të ardhura për tu regjistruar në vitet pasardhëse” e cila hyn në grupin e llogarive rregulluese. Sipas rastit të çdo institucioni evidentohen të ardhurat që janë arkëtuar përpara ngjarjes ose veprimit që krijon të ardhura.

Llogaria 478 “Diferenca konvertimi -pasive” pasqyron diferencat pasive që lidhen me konvertimet që rezultojnë nga vlerësimi me kurset e këmbimit në mbyllje të ushtrimit (të kërkesave debitore dhe detyrimeve) të shprehura në monedha të huaja.

Llogaria 480 “Të ardhura për t’u klasifikuar ose për tu rregulluar” pasqyron të ardhura të arkëtuara, por me dokumentacion të pa plotësuar ose të paqartë deri në datën e mbylljes së bilancit kontabël të institucionit. Teprica kreditore e kësaj llogarie kërkon sqarime në të dhënat shpjeguese.

Llogaria 487 “Të ardhura të arkëtuara para nxjerrjes së urdhrin” regjistron të ardhurat e arkëtuara, të cilat ekzistojnë në institucion të derdhura por nuk është marrë konfirmim nga Thesari deri në fund të periudhës ushtrimore.



Aneksi V:

Dokumentimi i levizjes së aktiveve.

(Bazuar në UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”).

- Veprimet ekonomike që kryhen në njësitë publike si dhe faktet që kanë sjellë ose mund të sillnin ndryshime në pasurinë që ato kanë në administrim e ruajtje, pasqyrohen kurdoherë në dokumentet përkatëse dhe menjëherë pasi kryhet veprimi.

- Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen në:

a. Dokumente autorizues – janë ato dokumente që autorizojnë kryerjen e një veprimi të caktuar ekonomike që i bashkëlidhet dokumentit vërtetues. Të tilla janë urdhrat e blerjeve, kontratat, urdhri për krijimin e komisioneve, urdhër për nxjerrje jashtë përdorimit, etj.

b. Dokumente vërtetues – vërtetojnë kryerjen në fakt dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletë hyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandatarkëtimet, mandatpagesat, procesverbalet, dhe te tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi.

c. Dokumente të kontabilitetit – janë dokumentet përmbledhës, ose regjistrat kontabël (*libri i madh, librat analitike, kartelat e aktiveve, etj*) të çdo lloji forme, bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

- Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kane urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore, ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë si dhe atë të mashtrimeve.

- Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletë hyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletë hyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jetë bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit (*Procesi i marrjes në dorëzim të aktiveve, referuar kushteve të përcaktuara në kontrate*).

- Dalja e aktiveve nga magazina bëhet mbi bazën e urdhërdorëzimit, fletëkërkesës, planit të shpërndarjes e kartelës limit dhe dokumentohet me fletë daljen ose me dokument tjetër të njehsuar me të sipas specifikave të aktiveve.

- Çdo hyrje-dalje në magazinë dokumentohet menjëherë. Aktivitetet që hyjnë pjesë-pjesë për në vendmbërritje, pasqyrohen me dokumente të përkohshme, por fletë hyrja ose fletë dalja për gjithë sasinë plotësohet me mbërritjen e gjithë sasisë së aktivitetit, duke u bashkëlidhur edhe dokumentet e përkohshme.

- Magazinieri dorëzon tek nëpunësi përgjegjës për financat e njësisë nga një kopje origjinale për fletë hyrjet, faturën e furnizuesit (*shitësit*) si dhe fletë daljen, si dhe hedh në kartelat e magazinës lëvizjet përkatëse në sasi dhe në vlerë sipas afateve të përcaktuara nga njësitë publike në funksion të specifikës së aktivitetit të tyre.

- Në raste të caktuara sipas nevojave të njësisë publike, behet dërgimi i aktiveve drejtpërdrejt nga furnizuesi ose dhuruesi te përdoruesi (*p.sh direkt në njësinë shpenzuese të njësisë publike*) dhe bëhen hyrje e dalje pa kaluar në magazinë (*psh. Në magazinën qendrore të njësisë publike*). Në këtë rast duhet të miratohen nga Nëpunësi Autorizues i njësisë publike procedura të qarta të lëvizjes, të shoqëruara me përgjegjësitë respektive. Veprimet bëhen në prani të punonjësve të ngarkuar me administrimin e aktiveve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “INSPEKTORATIN QËNDROR”

Aneksi VI:

Transaksionet e Inspektoratit Qëndror, Tiranë

Urdhër Shpenzimet e mëposhtëm u audituan në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik” për regjistrimin e veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si; *Dokumentet autorizues, Dokumente vërtetues, Dokumente të kontabilitetit, etj.*

Viti 2018

Urdhër shpenzim i	Data	Objekti I shpenzimit	Shuma
44	12.04.2018	Dieta dhe shpenzime për udhëtim jashtë shteti, Tokio, Japoni.	130,130
61	26.04.2018	Bileta avioni Tiranë-Tokio	226,700
75	15.05.2018	Sistemi i kamerave për Inspektoriatin Qendror (ABS)	223,584
83	05.06.2018	Shpenzime për udhëtime jashtë vendit (akomodim hoteli Londër)	193,180
84	05.06.2018	Shpenzime për udhëtime jashtë vendit (akomodim hoteli Paris, France)	89,900
85	05.06.2018	Bileta avioni Tiranë-Londer-Tiranë(dy persona)	169,575
136	01.10.2018	Siguracion makine TPL, Kasko e pjesshme dhe Kasko e plotë (automjetet e reja të IQ)	499,924
164	15.11.2018	Shërbim Spot grafik informuar me karaktere për rregulloren e Proc.Inspekt.	756,000
190	13.12.2018	Blerje toner për printer, fotokopje.	138,720
Totali			2,427,713

8-mujori i Vitit 2019

Urdhër shpenzim i	data	Objekti I shpenzimit	Shuma
75	16.05.2019	Pajisje informatike të blera, Fotokopje multifunksionale	536,400
82	05.06.2019	Shërbime mirëmbajtjeje, Sistemi i kondicionimit.	106,000
83	05.06.2019	Shërbim larjeje të automjeteve të IQ. Person fizik	178,400
Totali			820,800